EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5728
E hënë, 18 mars 2019
çmimi 0.40 €

22 persona kanë vdekur për dy muaj në aksidentet në trafik

FAQE 6

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", MELIHATE TËRMKOLLI FAQE 4-5

Taksa duhet të pezullohet

Ish-deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e LDK-së, Melihate Tërmkolli, ka thënë se Qeveria e Kosovës urgjentisht duhet ta pezullojë taksën ndaj produkteve serbe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se tashmë kjo taksë po prodhon vetëm efekte kundër Kosovës. Sipas saj, në këtë mënyrë Kosova po e dobësون edhe më tutje pozicionin dialogues në raport me Serbinë. Tërmkolli ka vlerësuar se mosrespektimi i këshillës amerikane për këtë çështje është duke rrezikuar seriozisht interesat e vendit. Në këtë situatë, ajo ka thënë se konsensusi është i domosdoshëm, që nënkupton një qeveri gjithëpërfshirëse me LDK-në në krye të këtyre proceseve ose mbajtjen e zgjedhjeve të reja. Tërmkolli në këtë intervistë ka folur edhe për zgjedhjet në LDK, ku thotë se pret një proces fer dhe demokratik

HARADINAJ: KOSOVA E 17 SHKURTIT ËSHTË KOMPROMISI YNË I FUNDIT

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka ritheksuar qëndrimin e tij kundër ndryshimit të kufijve. Ai ka thënë të dielën se Kosova e 17 shkurtit është kompromisi i fundit që ka bërë vendi ynë. Haradinaj ka thënë se tani jemi në kohën kur duhet ta mbrojmë shtëpinë, tokën dhe atdheun tonë FAQE 3

Vetëvendosja: Mosfunksionalizimi i KQZ-së pengon veprimin e opozitës

AKTUALE

TAKSA DHE RECIPROCITETI I PLOTË, ÇELËSI I MARRËDHËNIEVE KOSOVË - SERBI

F. 11

Blerim MURIQI

KOMANDANTI ZEMËRSHQIPONJË ENVER ZYMER AVDYLI-RAFUNA, NJERIU I PËRKUSHTIMIT ATDHETAR GJITHËKOMBËTAR

F. 14-15

Shkruan: Afrim MUSTAFA

PËR DY MUAJ NË KLINIKËN E KIRURGJISË VASKULARE JANË KRYER 180 OPERACIONE

F. 6

EKONOMI

RESTORANTI 'KANINA', 100 PËR QIND USHQIM VENDOR

F. 8

NGA SOT PRITET T'I MARRIN PAGAT TË GJITHË PUNËTORËT E 'TREPÇËS'

F. 8

SPORT

FERONIKELI SHKATËRRON '89-SHIN, LLAPI GABON NDAJ BALLKANIT

F. 18

PANUCCI: TURQIA SUPERIORE, POR BESOJ TE FITORJA

F. 19

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Tahiri në OKB kërkon drejtësi për gratë e dhunuara në Kosovë

PRISHTINË, 17 MARS - Ish-zëvendëskryeministrja dhe kryenegociatorja Edita Tahiri, në cilësinë e kryetares së Lobit Rajonal të Grave të Evropës Juglindore (RWLSEE), ka qëndruar në OKB, ku ka marrë pjesë në punimet e sesionit të 63-të të Komisionit për Statusin e Grave, e ftuar nga UN Women në Nju Jork.
Në panelin e OKB-së me temë "Rruga deri në vitin 2020: Përshpejtimi i veprimeve për gratë, paqen dhe sigurinë", Tahiri ishte së bashku me udhëheqësit kryesorë të OKB-së për statusin e grave, Phumzile Mlambo-Ngcuka, nënsekretare e përgjithshme e OKB-së dhe drejtoresh ekzekutive e UN Women, Jean-Pierre LaCroix, nënsekretar i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për operacionet e paqes dhe personalitete tjera nga vende të ndryshme.
Qëllimi i këtij sesioni që në përvjetorin e njëzetë të Këshillit të Sigurimit (Rezoluta 1325 (2000)) që po afrohet shpejt në vitin 2020, shtetet anëtare, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile të kenë një mundësi unike për të rritur vrullin dhe për të përshpejtuar veprimet drejt zbatimit.
Ky sesion interaktiv ka ofruar hapësirë për pjesëmarrësit në sesionin e 63-të të Komisionit për statusin e grave për të shprehur idetë e tyre dhe shqetësimet, si dhe të japin kontribut për prioritetet që janë duke u formuluar nga aktorët kryesorë dhe vendimmarrësit.
Gjatë fjalës së saj, Tahiri ka thënë se paqja në Ballkan nuk ka përfunduar. "Ballkani është në një situatë ku paqja është e papërfunduar, prandaj duhet integruar më shpejt shtatë vendet në BE dhe NATO, para se Ballkani ta bën surprizën e radhës", ka thënë Tahiri.
Më tutje, ajo ka kërkuar drejtësi edhe për gratë e dhunuara gjatë

luftës në Kosovë. "Drejtësia ndërkombëtare duhet të veprojë që t'ua sjellë dinjitetin viktimave, ndërsa kriminelet duhet të marrin dënimin e merituar", është shprehur Tahiri.

Protestuesit serbë kërkojnë rrëzimin e Vuçiqit

Derisa mijëra veta në Beograd edhe të dielën kanë vazhduar protestat para ndërtesës së presidencës së Serbisë, presidenti serb Aleksandër Vuçiq tha se nuk do të lejohet askush ta kërcënojë Serbinë me dhunë ndërsa i cilësoi si fashistë disa nga drejtuesit e opozitës serbe

BEOGRAD, 17 MARS - Mijëra veta në Beograd u hodhën në protesta në mesditën e së dielës para ndërtesës së Presidencës së Serbisë në kohën kur presidenti serb Aleksandër Vuçiq po i drejtohej vendit pas protestave të së shtunës, kur grupe qytetarësh hynë në ndërtesën e Televizionit Shtetëror në shenjë pakënaqësie me qasjen e njëanshme të tij.
Presidenti serb tha se "nuk do të lejohet askush ta kërcënojë Serbinë me dhunë", ndërsa i cilësoi si "fashistë" disa nga drejtuesit e opozitës serbe. Forca të mëdha të policisë rrethuan për disa orë me radhë ndërtesën e Presidencës serbe, ndërsa protestuesit kërkuan dorëheqjen e presidentit serb, i cili u largua nga zyrat e tij pasi protestuesit u larguan nga sheshi para Presidencës.
Të shtunën policia ndërhyri në ndërtesën e Televizionit Shtetëror Serb dhe nxori prej andej grupet e protestuesve, përfshirë edhe disa udhëheqës opozitarë, të cilët kërkonin që t'u jepej hapësirë në emisionet qendrore të lajmeve.
Drejtuesit e opozitës thanë se policia përdori dhunë ndaj protestuesve paqësorë. Ministri i Brendshëm serb, Nebojsha Stefanoviq, paralajmëroi përndjekjen e atyre që hynë në ndërtesë, ndërsa ministri serb i Mbrojtjes, Aleksandër Vulin, i tha televizionit pro qeveritar "Pink" se protestuesit janë "fashistë" dhe duhet të dënohen me ashpërsi.
Ky ishte incidenti më i rëndë pas disa muajsh protesta kundër presidentit serb dhe protestuesit po kërkojnë dorëheqjen tij, zgjedhje dhe medie të lira dhe më shumë demokraci.
Kritikët e akuzojnë presidentin Vuçiq për vendosje të autokracisë nëpërmjet kontrollit të rreptë të medies dhe nxitjes së gjuhës së urrejtjes ndaj kundërshtarëve. Ai i ka hedhur poshtë këto akuza.
Protestuesit kërkuan liri të medies si parakusht për zgjedhje të lira e të drejta.
Protestat me sloganin "Një nga pesë milionë", filluan në nëntor të vitit të kaluar me moton "stop këmishëve të përgjakura", kur ndodhi një sulm mbi Borislav Strefanoviqin, udhëheqës i partisë së vogël E Majta Serbe. Ai ishte sulmuar nga një grup burrash me maska të zeza më 23 nëntor në Krushevc, një qytet në jug të Serbisë dhe kishte pësuar plagë të lehta.
Në muajin dhjetor, presidenti serb tha se nuk do t'i përmbushë kërkesat e opozitës edhe nëse "dalin 5 milionë në rrugë", por më pas ai tha se është i gatshëm të çojë vendin në zgjedhje të parakohshme. Partitë opozitare thanë se do t'i bojkotonin zgjedhjet e tilla.
Ish-nacionalisti i skajshëm, Aleksandër Vuçiq, thotë se synon të anëtarësojë Serbinë në Bashkimin Evropian.

Protesta para parlamentit, policia arreston 14 persona

TIRANË, 17 MARS - Policia shqiptare njoftoi se ka arrestuar 14 persona ndërsa 7 të tjerë janë në kërkim, për aktet e dhunës që u regjistruan gjatë protestës të së shtunës të opozitës para parlamentit. Për 11 pjesëmarrës të tjerë në protestë ka nisur procedimi penal në gjendje të lirë. I njëjti vendim është marrë dhe për sekretarin e përgjithshëm të Partisë Demokratike Gazmend Bardhi, si personi që në emër të kësaj force politike kishte kërkuar leje pranë policisë.
Të arrestuarit akuzohen për veprat penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme", "Goditje për shkak të detyrës", "Kundërshtim me dhunë të punonjësit të policisë", "Prishje të rendit dhe qetësisë publike" dhe "Mbajtja dhe përdorimi i lëndëve plasëse".
Policia shpjegoi se "veprimet procedurale janë kryer në bazë të një analize të pamjeve filmike, raport shërbimeve, si dhe provave të tjera të mbledhura nga grupi hetimor. Në vendngjarje policia ka mbledhur në cilësinë e provës materiale rreth 130 kapsolla të ndaluara si të rrezikshme për jetën".
Nga ana e saj Partia Demokratike akuzoi të shtunën policinë se përshkallëzoi dhunën e paprovokuar ndaj protestuesve me të vetmin qëllim, për t'i shpërndarë, për t'i trembur, për t'i larguar nga rruga e protestës, por përgjigjen e mori nga populli.
Protesta e opozitës nisi para godinës së qeverisë dhe pasoi me dy marshime rreth e qark zonës, duke simbolizuar rrethimin e saj.
Më pas nën drejtimin e udhëheqësve të opozitës, protesta u spostua para parlamentit. Gjithçka

po vijonte po qetësisht, kur një grup protestuesish u konfrontuan me policinë, duke tentuar të çajnë rreshtimin e tyre para hyrjes qendrore. Reagimi ishte i menjëhershëm me gaz lotsjellës.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Haradinaj: Kosova e 17 shkurtit është kompromisi ynë i fundit

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka ritheksuar qëndrimin e tij kundër ndryshimit të kufijve. Ai ka thënë të dielën se Kosova e 17 shkurtit është kompromisi i fundit që ka bërë vendi ynë. Haradinaj ka thënë se tani jemi në kohën kur duhet ta mbrojmë shtëpinë, tokën dhe atdheun tonë

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 17 MARS- Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka ripërsëritur të dielën qëndrimin e tij, se është kundër çfarëdo ndryshimi të kufijve. Ai ka thënë se deri më tani Kosova dhe shqiptarët kanë dhënë mjaftueshëm për të tjerët dhe për paqen në Ballkan. Sipas Haradinajt, tani ka ardhur koha të kujdesemi për tokën tonë, për atë që ka mbetur e jona dhe atë që është e shqiptarëve.

Kryeministri Haradinaj ka vlerësuar se rrjedhat e historisë dhe brezi i UÇK-së e ka ndryshuar këtë, prandaj më askush nuk mund të marrë tokë. "Ne në Kosovë jemi në të drejtën tonë, kemi pranuar në tokën dhe në shtëpinë tonë popujt që kanë ardhur nga larg, dhe iu kanë lëshuar tokë e hapësirë dhe këtë e di dhe e thotë edhe historia. Por, tani jemi në kohën kur ne duhet të kujdesemi për shtëpinë, tokën tonë, për atdheun tonë, sepse nëse ka popull në Ballkan që ka dhënë për të tjerët, ata jemi ne. Dihet historikisht që ndër shekuj shqiptarët kanë dhënë territore të veta, nga e drejta e vet, nga ajo që ua ka lënë Zoti në Ballkan, për popujt e tjerë. Ka ardhur koha dhe jemi në kohën kur duhet të kujdesemi për tokën tonë, për atë që ka mbetur e jona dhe atë që është e shqiptarëve", ka thënë ai.

Kryeministri ka thënë se Kosova është edhe e komuniteteve. "Kur e them atë që është e shqiptarëve, kurrë nuk harroj të them se kushdo që jeton me ne, komunitetet etnike, janë në shtëpinë e vet dhe ne dimë t'i nderojmë, por nuk ka më kthim prapa dhe nuk ka më vazhdim të praktikave me marrë prej shqiptarëve. Brezi i UÇK-së e ka ndryshuar këtë, rrjedhat e historisë kanë ndryshuar dhe prej shqiptarëve më askush nuk mund të marrë", ka deklaruar kryeministri Haradinaj në shënimin e 20-vjetorit të betejës së Kabashit. Ai ka thënë se Kosova e 17 shkurtit është kompromisi i fundit që ka bërë vendi ynë.

Haradinaj ka thënë se shqiptarët janë ata që kanë dhënë në vazhdimësi dhe nuk mund të japin më për paqe. "Kosova e 17 shkurtit është një kompromis, një minimum i të drejtës së shqiptarëve dhe kushdo që e prek këtë kompromis të së drejtës së shqiptarëve, atëherë e hapë pyetjen tjetër për të drejtën e shqiptarëve në Ballkan. Kemi rënë dakord për ta realizuar të drejtën tonë, Kosovën e 17 shkurtit, të bindur se kështu po dëshmojmë edhe një herë se jemi për paqe dhe stabilitet në Ballkan, duke u bërë thirrje të gjithëve të ndihmojnë në arritjen e paqes në Ballkan, por jo duke kërkuar prej shqiptarëve për paqe në Ballkan. Ne jemi ata që kemi dhënë në vazhdimësi dhe nuk mund të japim më për paqe, veç asaj që është e vërteta jonë", është shprehur Haradinaj.

Më tutje, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se të gjithë duhet ta kuptojnë se, përveç asaj që ndodh mes nesh, brenda popullit tonë, pra pluralizmit, demokracisë, garave të brendshme, nuk duhet të harrojnë se jemi të rrethuar nga kundërshtarët. "Duhet të dimë se gjatë garës që kemi brenda nesh mos të harrojmë se jemi në garë edhe me kundërshtarët jashtë nesh. Një pjesë e atyre që kanë bartur mbi supe rrugën e mundimshme të lirisë nuk e harrojnë këtë dhe nuk do ta harrojnë kurrë se, përpos garës brenda nesh, jemi në garë edhe me të tjerë, jemi në garë me fqinjët grabitqarë që kanë dëshmuar në histori", ka theksuar Haradinaj.

Mustafa kërkon dorëheqjen e qeverisë

PRISHTINË, 17 MARS (ER) - Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë të dielën se taksën e kësaj qeverisjeje nuk po e paguan Serbia dhe Bosnja, por Kosova. Mustafa ka thënë se dyqanet janë përplot me mallra serbe dhe boshnjake por, sipas tij, qytetarët gjithnjë e më shumë po e paguajnë taksën e evazionit fiskal, korrupsionit, nepotizmit dhe punësimit partiak. "Tarifën e kësaj qeverisjeje nuk po e paguajnë Serbia dhe Bosnja. Njëqind për qind po e paguan Kosova. Derisa Drejtoria e Doganës deklaron se importet nga këto vende kanë rënë 99 për qind, shitoret janë përplot me mallra serbe dhe boshnjake. Kështu thonë qytetarët. Ndërkaq ne gjithnjë e më shumë po e paguajmë taksën/tarifën e evazionit fiskal, korrupsionit, nepotizmit dhe punësimit partiak; po e paguajmë lobimin e njërit dhe tjetrit, kapjen e kompanive publike dhe agjencive të pavarura; po e paguajmë targën e abstenimit të prokurorisë dhe gjyqësisë ndaj shkeljeve dhe abuzimeve; targën e shkeljeve të Kushtetutës si pasojë e pazareve të koalicionit qeverisës për votat që i mungojnë për të qeverisur", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas Mustafës, në Kosovë për më shumë se një vit dialogu për marrëveshjen përfundimtare me Serbinë ka bërë që institucionet dhe opinioni publik të mos merren me zhvillim ekonomik, punësim, arsim dhe probleme të shëndetësisë. Ai ka thënë se dialogu është shndërruar në instrument për ta mbajtur pushtetin. "Thua se ushqimi për popullatën tonë është dialogu, se arsim është dialogu e shëndet është dialogu me Serbinë! Dialogu është shndërruar në garë për t'ia treguar njëri-tjetrit muskujt brenda koalicionit të brishtë qeverisës, por edhe në instrument për ta mbajtur pushtetin. Është bërë si arenë e gladiatorëve, ku sunduesit e zhvendosnin vëmendjen e qytetarëve nga problemet e tyre", ka theksuar Mustafa.

Kryetari i LDK-së ka thënë se zgjidhja më e mirë do të ishte dorëheqja e këtij koalicioni qeverisës. "Nëse dikush nga koalicioni qeverisës e do këtë vend, që nuk dyshoj se ka të tillë, atëherë duhet ta pranojnë se e kanë mashtruar popullin dhe vetveten me parullat e PDK-së të vendimeve të mëdha, dhe se

vendimi i vetëm i drejtë i tyre është të japin dorëheqje. Të vetëshkarkohen e të shkojmë në zgjedhje. Dhe, vendim i drejtë i ndërkombëtarëve do të jetë të mos bëjnë presion për dialog, sepse asgjë e mirë, përpos ushqimit të popullizmit, nuk arrihet nën presion të tillë", është shprehur Mustafa.

Flet për "Epokën e re", Melihate Tërmkolli

Taksa duhet të pez

Ish-deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e LDK-së, Melihate Tërmkolli, ka thënë se Qeveria e Kosovës urgjentisht duhet ta pezullojë taksën ndaj produkteve serbe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se tashmë kjo taksë po prodhon vetëm efekte kundër Kosovës. Sipas saj, në këtë mënyrë Kosova po e dobëson edhe më tutje pozicionin dialogues në raport me Serbinë. Tërmkolli ka vlerësuar se mosrespektimi i këshillës amerikane për këtë çështje është duke rrezikuar seriozisht interesat e vendit. Në këtë situatë, ajo ka thënë se konsensusi është i domosdoshëm, që nënkupton një qeveri gjithëpërfshirëse me LDK-në në krye të këtyre proceseve ose mbajtjen e zgjedhjeve të reja. Tërmkolli në këtë intervistë ka folur edhe për zgjedhjet në LDK, ku thotë se pret një proces fer dhe demokratik

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 17 MARS - Ish-deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Melihate Tërmkolli, ka bërë me dije se taksa ndaj produkteve serbe duhet të pezullohet. Ajo ka thënë se tashmë kjo taksë po prodhon vetëm efekte kundër Kosovës duke e dobësuar edhe më tutje pozicionin në dialogun me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka treguar se njohja e Kosovës nga Serbia do të arrihet vetëm me ndihmën e ShBA-së. "Taksa tashmë duhet të pezullohet urgjentisht. Nuk u menaxhua në arritjen e qëllimeve të deklaruara. Njohja e Kosovës nga Serbia realizohet vetëm me përkrahjen dhe bashkëpunimin e ngushtë me ShBA-në dhe miqtë e tjerë. Taksa tani po prodhon vetëm efekte kundër Kosovës duke dobësuar edhe më tutje pozicionin tonë dialogues. Sugjerimet për pezullim të taksës janë nga të gjithë miqtë e partnerët tanë më të mëdhenj, nga ShBA-ja, Gjermania, Britania e Madhe etj", ka thënë ajo.

Ajo ka vlerësuar se qeveria me mosrespektimin e këshillës amerikane për këtë çështje është duke rrezikuar interesat e vendit. "Qëndrimi i Qeverisë PAN lidhur me taksën po rrezikon seriozisht interesat e vendit tonë, ndërsa roli i drejtuesve të PDK-së në këtë rast është tepër hipokrit dhe skajshmërisht i dëmshëm. Duhet të jemi në përputhje me gatishmërinë e miqve tanë për dialog që do të sjellë njohje reciproke. Të gjithë na kanë njohur në kufijtë ekzistues të shtetit tonë", është shprehur Tërmkolli.

Zyrtarja e LDK-së ka folur edhe për zgjedhjet e brendshme të kësaj partie që pritet të fillojnë së shpejti. Tërmkolli pret që në këto zgjedhje do të jetë një proces normal dhe i rregullt zgjedhor. "LDK-ja ka shumë personalitete të tilla, filluar nga presidenti Sejdiu dhe të tjerë që janë përmendur e nuk janë përmendur. Në rrethanat në të cilat gjendet vendi ynë, LDK-ja nuk ka as kohë e as mundësi për eksperimente. LDK-së i duhen të gjithë", është shprehur ajo, duke shtuar se është e mundshme një marrëveshje politike e LDK-së për këtë çështje. "Marrëveshja është e mundshme dhe e dobishme gjithnjë derisa

ullohet

është e sinqertë dhe korrekte me veten dhe të tjerët. Unë besoj në LDK-në, në brumin e saj të frymës rugoviane moderne", ka thënë Tërmkolli.

"Epoka e re": *Znj. Tërmkolli, cili është vlerësimi juaj për situatën politike në vend?*

Tërmkolli: Është situatë e rëndë, e tensionuar edhe brenda, edhe në marrëdhëniet me miqtë dhe partnerët tanë më të mëdhenj. Jemi në një pikë rreziku serioz, ndërsa po sillemi sikur jemi maja e botës dhe krejt bota varet nga ne. Është sjellje zaptuesish të shtetit, të jetës së qytetarëve, sjellje bajraktarësh me elemente të diktatorëve të vegjël. Pasojat për shtetin dhe qytetarët, për të sotmen dhe të ardhmen, janë të paimagjinueshme. Shqetësohem shumë për mundësinë e eskalimit të gjendjes, nga një krizë dhe trazira që na kthejnë më mbrapa se zero. Shenjat për një mundësi të tillë janë të dukshme, edhe interesi i Serbisë e Rusisë për diçka të tillë është evident. Ndërsa ne po shesim "çallmë" me Amerikën.

"Epoka e re": *Kosova është në prag të fillimit të fazës finale të dialogut me Serbinë, por pozita dhe opozita ende nuk kanë arritur një konsensus për këtë çështje, ndonëse kemi një delegacion shtetëror dhe një platformë të miratuar në kuvend. A është i mundshëm konsensusi nacional?*

Tërmkolli: Nuk ka delegacion shtetëror dhe as platformë konsensuale. Edhe delegacioni edhe platforma janë të Qeverisë PAN, madje jo me përfaqësuesit e parë të tyre. Jashtë tyre janë subjektet më të mëdha politike, LDK-ja, VV-ja, PDK-ja, përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe personalitete të shoqërisë civile. Kryeministri hoqi dorë nga detyrimi kushtetues për t'i udhëhequr bisedimet. Nuk është pjesë as kryetari i Kuvendit. Nuk dihet raporti i delegacionit me presidentin. Konsensusi është i domosdoshëm dhe ai nënkupton një qeveri të riformatuar gjithëpërfshirëse me LDK-në në krye të këtyre proceseve ose mbajtja e zgjedhjeve të reja.

"Epoka e re": *Pavarësisht prej kërkesës së vazhdueshme të miqve ndërkombëtarë për pezullimin e taksës ndaj mallrave serbe, qeveria po vazhdon ta mbajë taksën. Çfarë duhet të bëjë qeveria dhe a po lëndohen raportet me ShBA-në në këtë mënyrë?*

Tërmkolli: Taksa tashmë duhet të pezullohet urgjentisht. Nuk u menaxhua për arritjen e qëllimeve të deklaruara. Njohja e Kosovës nga Serbia realizohet vetëm me përkrahjen dhe bashkëpunimin e ngushtë me ShBA-në dhe miqtë e tjerë. Taksa tani po prodhon vetëm efekte kundër Kosovës duke dobësuar edhe më tutje pozicionin tonë dialogues. Sugjerimet për pezullim të taksës janë nga të gjithë miqtë e partnerët tanë më të mëdhenj, nga ShBA-ja, Gjermania, Britania e Madhe etj. Qëndrimi i Qeverisë PAN lidhur me taksën po rrezikon seriozisht interesat e vendit tonë, ndërsa roli i drejtuesve të PDK-së në këtë rast është tepër hipokrit dhe skajshmërisht i dëmshëm. Duhet të jemi në përputhje me gatishmërinë e miqve tanë për dialog që do të sjellë njohje reciproke. Të gjithë na kanë njohur në kufijtë ekzistues të shtetit tonë.

"Epoka e re": *LDK-ja shumë shpejt pritet ta nisë procesin e brendshëm zgjedhor. Si pritni të shkojë ky proces?*

Tërmkolli: Besoj do të jetë një proces normal dhe i rregullt zgjedhor. Fuqia politike e LDK-së është më e madhe sesa që mund të mendojnë dashakëqijtë.

"Epoka e re": *Tashmë disa prej figurave kryesore të këtij subjekti politik kanë lënë të kuptohet se do të kandidojnë për kryetar të LDK-së. Pretendimi i shumë kandidaturave për këtë post, a mund të nxisë përçarje të brendshme?*

Tërmkolli: Pretendimi për kandidim është normal dhe legjitim për secilin anëtar të LDK-së. Mendoj se LDK-ja në çdo fazë të zgjedhjeve të brendshme do të demonstrojë pjekuri politike e kombëtare për ta zgjedhur kryetarin dhe mekanizmat e tjerë të saj me personalitete domethënëse jo veç për LDK-në, por edhe për Kosovën. LDK-ja ka shumë personalitete të tilla, filluar nga presidenti Sejdiu dhe të tjerë që janë përmendur e nuk janë përmendur. Në rrethanat në të cilat gjendet vendi ynë, LDK-ja nuk ka as kohë e as mundësi për eksperimente. LDK-së i duhen të gjithë.

"Epoka e re": *Z. Lutfi Haziri veçse e ka bërë publike kandidaturën për postin e të parit të LDK-së. Ai ka thënë se kësaj parti i duhet një marrëveshje politike për këtë çështje. Sa është e mundshme kjo?*

Tërmkolli: Marrëveshja është e mundshme dhe e dobishme derisa është e sinqertë dhe korrekte me veten dhe të tjerët. Unë besoj në LDK-në, në brumin e saj të frymës rugoviane moderne.

PDK-ja përfundon zgjedhjet e brendshme në Istog, Fushë-Kosovë dhe Graçanicë

Istog, 17 mars (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mbajtur të dielën zgjedhjet e brendshme në tri degë të saj, duke zgjedhur edhe kryetarët e rinj për zbatimin e platformës Dekada e Re. Pas përmbylljes së suksesshme nëpër dhjetëra nëndegë, PDK-ja ka përmbyllur zgjedhjet për zgjedhjen e strukturave të brendshme në degët e Istogut, Fushë-Kosovës dhe Graçanicës.

Në procesin zgjedhor në degën e Istogut, kryetar është zgjedhur Lulzim Shoshi, në një garë fer dhe demokratike në mes të tre kandidatëve. Po ashtu, është zgjedhur edhe Këshilli Drejtues i përbërë nga 71 anëtarë dhe delegatë për Konventën Zgjedhore të PDK-së. Punimet e këtij kuvendi i ka përshëndetur nënkryetari i PDK-së, Bajrush Xhemajli. Ai ka thënë se PDK-ja në nivel vendi po fuqizohet nëpërmjet procesit të brendshëm zgjedhor. Po ashtu, Xhemajli ka thënë se PDK-ja gjatë këtij procesi po rritet dhe fuqizohet edhe më shumë.

Ndërsa në Kuvendin Zgjedhor të Degës së PDK-së në Fushë-Kosovë, 131 delegatët pjesëmarrës zgjodhën me shumicë votash Rrahim Tërnavën për kryetar dege dhe 55 anëtarë për Këshillin Drejtues të degës.

Në emër të kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli, të pranishmit i përshëndeti nënkryetari Hajredin Kuçi, i cili tha se PDK-ja edhe në Dekadën e Re do të jetë parti lidere e cila do t'u prijë reformave për integrimet euroatlantike të vendit.

Ndërsa në Kuvendin Zgjedhor të Degës së PDK-së në Graçanicë, kryetar i degës me shumicë votash është zgjedhur Artan Ismajli.

Partia Demokratike e Kosovës në procesin e brendshëm zgjedhor deri tani ka mbajtur rreth 700 kuvende të nëndegëve nga 1 200 sa i ka gjithsej, ndërsa procesi zgjedhor ka përfunduar plotësisht në 14 degë.

22 persona kanë vdekur për dy muaj nga aksidentet në trafik

Policia e Kosovës ka njoftuar se nga janari i këtij viti deri më 17 mars kanë vdekur 22 persona si pasojë e aksidenteve në trafikun rrugor. Policia ka theksuar se kujdesi maksimal i pjesëmarrësve në trafik, posaçërisht i drejtuesve të automjeteve, është i domosdoshëm për t'i shmangur aksidentet fatale

EPOKA E RE Qendresa RAMA

Prishtinë, 17 mars - Policia e Kosovës (PK) ka vlerësuar se rastet e raportuara për humbje të jetëve njerëzore si pasojë e aksidenteve rrugore janë duke u bërë tepër shqetësuese për të gjithë.

Nëpërmjet një komunikate për medie, Policia e Kosovës ka theksuar se bashkë me kërkesat e vazhdueshme për kujdes dhe vigjilencë të shtuar nga drejtuesit e automjeteve ka ndërmarrë disa aktivitete dhe fushata vetëdijësuese për respektimin e rregullave të trafikut, si: respektimi i shenjave në rrugë, kufizimi i shpejtësisë, vënia e rripit të sigurisë etj. Në këtë kontekst, policia ka thënë se, përveç kësaj, në vazhdimësi ka realizuar operacione policore në funksion të zbatimit të ligjit të trafikut që bie në fushëveprimin policor, ku gjatë vitit 2018 janë shqiptuar gjithsejtë 400 095 kundërvajtje në trafikun rrugor. "Gjatë vitit 2018 janë shqiptuar gjithsejtë 400 095 kundërvajtje në trafikun rrugor: 6 485 shoferëve u është ndaluar drejtimi i mjetit me veprim motorik, 170 400 kundërvajtje për tejkalim të shpejtësisë, 1 824 kundërvajtje për mosrespektim të dritës së kuqe (semaforit), 11 883 kundërvajtje për kalim të afatit të regjistrimit të mjetit, ndërsa inkasimi i gjobave në vitin 2018 ka qenë 8 427 711 59 euro apo 140 për qind më shumë krahasuar me vitin 2017. Me gjithë këto përpjekje të Policisë së Kosovës, ku përfshihet edhe rritja e numrit të ndëshkimeve (gjobave në trafik), ky vit (2019) nga janari deri tani (17. 3. 2019) ka rezultuar me humbjen e 22 jetëve njerëzore nëpër rrugët tona, që prapë mbetet shqetësim i madh", ka njoftuar policia.

Sipas kësaj komunikate, policia ka theksuar se kujdesi maksimal i pjesëmarrësve në trafik, posaçërisht i drejtuesve të automjeteve, është i domosdoshëm për t'i shmangur aksidentet fatale dhe në këtë mënyrë të krijohet një siguri më e madhe në trafikun rrugor. "Po ashtu, ju njoftojmë se Policia e Kosovës, në kuadër të fushëveprimit të saj ligjor që ka, do të aplikojë masa rigoroze ndëshkuese ndaj të gjithë shkelësve të ligjit të trafikut, me të vetmin qëllim: për ngritjen e nivelit të sigurisë në trafik dhe parandalimin e aksidenteve rrugore në përgjithësi", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Për dy muaj në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare janë kryer 180 operacione

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 17 mars - Klinika e Kirurgjisë Vaskulare në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) ka rritur dukshëm vëllimin e punës, që ka ndikuar edhe në shtim të numrit të operacioneve. Në këtë klinikë, përveç operacioneve të rëndomta, po kryhen edhe operacione specifike.

Drejtori i Klinikës së Kirurgjisë Vaskulare, dr. Hajriz Rudari, ka thënë se në këtë klinikë ka filluar rritja e numrit të operacioneve krahasuar me vitin e kaluar, me një përqindje më të madhe. Sipas tij, përveç kësaj, po punohet që pacientët të mos kërkojnë trajtim jashtë vendit për rastet të cilat mund të kryhen edhe në QKUK. "Edhe kushtet kanë filluar të përmirësohen, prandaj pacientët mos të hezitojnë të vijnë dhe të kërkojnë shërbim. Në bazë të statistikave, kemi kryer 80 operacione më shumë për të njëjtën kohë sesa në dy muajt e parë të vitit të kaluar. Në periudhën janar - shkurt të vitit 2018 janë kryer 100 operacione, kurse në këtë vit, për periudhë të njëjtë kohore, janë realizuar 180", ka theksuar drejtori Rudari.

Ai ka thënë se tashmë puna është lehtësuar meqë ka ardhur edhe ultrazëri i ri, i cili ka një rol jashtëzakonisht të madh për trajtimin e rasteve. Një nga operacionet e fundit specifike që është kryer me sukses, është edhe operacioni tek një paciente e moshuar, tek e cila është kryer bypass arteria e poplitealis në këmbën e majtë.

Dr. Luzim Vokrri, i cili ka kryer operacionin bashkë me ekipin mjekësor të kirurgjisë vaskulare dhe atë të Klinikës së Anestezionit, u shpreh se ky operacion është bërë me mjaft sukses te një paciente e moshuar, e cila, krahas mbylljes së arterieve të gjakut në ekstremitetet e poshtme, në këmbë, ka edhe sëmundje të tjera shoqëruese. "Pacientja është diabetike, ka diabet më shumë se 30 vjet, në momentin kur ka ardhur te ne, ka ardhur në stadin e katërt të sëmundjes. Domethënë, në këmbën e majtë ka pasur plagë, ndërsa në gishtin e këmbës së majtë ka pasur gangrenë, domethënë është stadi përfundimtar, kur indet e buta pothuajse vdesin",

është shprehur dr. Vokrri. Sipas tij, për operacion është vendosur pasi që enët e gjakut, prej gjurit deri te zogu i këmbëve, ishin të mbyllura dhe ishte vendosur të bëhet bypass. Ai ka theksuar se tani pacientja gëzon shëndet të mirë dhe nëse nuk do ta realizohej bypass, është dashur t'i bëhej prerja e këmbës deri në gju. Pacientja më parë ishte vizituar edhe tek mjekët në Shkup, të cilët i kishin thënë se nuk kishte zgjidhej tjetër, përveç amputimit të këmbës.

Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje kanë mbajtur konferencë për media

Vetëvendosja: Mosfunksionalizimi i KQZ-së pengon veprimin e opozitës

Nënkryetarja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, ka thënë të dielën se mosdekretimi i anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), bazuar në Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, po e pengon veprimin e partive opozitare. Ndërsa ish-përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje në KQZ, Adnan Rrustemi, ka thënë se shkëputja njëvjeçare nga punët e përditshme dhe të planifikuara do të ndikojë në cilësinë e aktiviteteve të këtij institucioni

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

Prishtinë, 17 mars - Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje të dielën kanë mbajtur konferencë për media, në të cilën kanë folur për dëmet që po shkaktohen nga bllokimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Me këtë rast, nënkryetarja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, ka thënë se me mosdekretimin e anëtarëve të KQZ-së, presidenti Hashim Thaçi është duke e bllokuar veprimtarinë e partive opozitare të cilat varen nga fondet e KQZ-së. Ajo ka theksuar se për këtë gjë do të ishte dashur që edhe partitë në pushtet të shqetësoheshin por, sipas saj, këto parti kanë edhe të tjera mënyra për të mbijetuar. "Nuk ka ditë që ky president nuk po na jep prova që jo vetëm se nuk është president konsensual, por as nuk e përfaqëson vullnetin e popullit. Me mosdekretimin e anëtarëve të KQZ-së, bazuar në Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, që për rrjedhojë bllokon fondet që u takojnë të gjitha subjekteve politike, vërehet se qëllimi është të pengohet veprimi i opozitës që deri në një masë është edhe i varur nga ato fonde që rrjedhin nga një organ kushtetues. Ky shqetësim do të duhej t'i prekte edhe partitë në pushtet por, si duket, ato kanë burime të tjera mbijetese", ka deklaruar Kollçaku-Mulhaxha, duke shtuar se është shqetësim i madh që KQZ-ja ka mbetur e bllokuar tash e sa muaj dhe presidenti po lejon këtë gjë. "Ne shprehim shqetësimin e madh për mosdekretimin e anëtarëve të KQZ-së dhe na habit fakti se si ky president ia lejon vetes, mos ta marrë vendimin që i takon", është shprehur ajo.

Ndërsa ish-përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Adnan Rrustemi, ka thënë se bllokimi i këtij institucioni për tash e një vit e ka lënë shumë mbrapa këtë institucion në një varg të punëve dhe përgatitjesh. "Nga vlerësimi i aspekteve teknike të zgjedhjeve të kaluara dhe për marrjen e masave për t'i përmirësuar, deri te çështjet shqetësuese të përhershme si: pastrimi i listës së votuesve, hetimi i fletëvotimeve të shumta të pavlefshme, fushata informuese për votuesit, thjeshtimi dhe lehtësimi i mënyrës së votimit për diasporën, për votuesit me nevoja të veçanta, të gjitha këto e shumë të tjera janë bllokuar bashkë me bllokimin që i ka bërë Hashim Thaçi këtij institucioni të rëndësishëm kushtetues", ka thënë Rrustemi, duke shtuar se shkëputja njëvjeçare nga punët e përditshme dhe të planifikuara do të ndikojë në cilësinë e aktiviteteve të KQZ-së. "Në mungesë të KQZ-së nuk janë shqyrtuar dhe adresuar rekomandimet e auditorit të përgjithshëm, është pamundësuar realizimi i planit të punës të vitit të kaluar, nuk mund t'i raportojë Kuvendit për punën njëvjeçare siç e ka obligim ligjor, për muajin prill janë pamundësuar apo dëmtuar shumë projekte të rëndësishme për përmirësimin e zgjedhjeve dhe bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare. Është vënë në dyshim integriteti i KQZ-së dhe i vetë zgjedhjeve", është shprehur Rrustemi. Sipas tij, është pamundësuar marrja e çfarëdo vendimi nga ana e KQZ-së për një vit. "37 asamblistëve u është pamundësuar puna e tyre në disa komuna. Kjo ka ndikuar në marrjen e vendimeve. Një deputet ka mbetur pa mandat, 13 subjekte politike që tre muaj kanë mbetur pa fonde që ua garanton ligji, është bllokuar zgjedhja e drejtorit ekzekutiv të Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike, më 2 prill i përfundon kontrata edhe kryeshefit ekzekutiv dhe, për pasojë, defunksionalizohet edhe administrata", ka deklaruar Rrustemi.

Haradinaj merr pjesë në 20-vjetorin e betejës së Kabashit

Prizren, 17 mars (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të dielën në tubimin përkujtimor me rastin e 20-vjetorit të betejës së Kabashit dhe rënies së dëshmorëve Halim Ahmetaj, Rexhep Kukaj dhe Murat Kabashi. Me këtë rast, ai ka thënë se Kabashi është vend që i bashkon shqiptarët. "Nuk ka ngjarje të historisë sonë kombëtare ku nuk e gjen luftëtarin e Kabashit, dijetarin e Kabashit, kontributin e Kabashit. Më vjen mirë që kjo histori shqiptare vazhdoi edhe me luftën e fundit dhe më vjen mirë që Batalioni i Kabashit, i cili bashkoi rreth vetes, nëpër periudha të luftës, rreth 350 luftëtarë, e vazhdoi këtë traditë", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se edhe sot fëmijët që nxënë dije dhe mësimdhënësit që japin dije në shkollën "Dëshmorët e Kabashit", po ashtu e vazhdojnë këtë traditë të çmuar të shqiptarëve. Kryeministri Haradinaj në shenjë respekti i ka dhënë medaljen "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", Batalionit Kabashi, të cilën e ka pranuar komandanti Lulzim Kabashi. Në emër të kryesisë së fshatit, Rexhë Ukaj ka thënë se kjo ditë e karakterizon luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në mbrojtje të pragut të shtëpisë, mbrojtjen dhe nderin e krenarisë së Kabashit që e pati traditë dhe e kultivoi me shekuj.

Restoranti 'Kanina', 100 për qind ushqim vendor

Në Bregun e Diellit në kryeqytet, saktësisht në rrugën "Gazmend Zajmi", ndodhet restoranti "Kanina", në të cilin mund të gjeni 100 për qind prodhime vendore dhe ushqime tradicionale nga trevat e ndryshme shqiptare

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 MARS - Në restorantin "Kanina" të gjitha ushqimet janë tradicionale dhe shërbehen në mënyrë tradicionale. Ushqimi përmban shije të gatesave të "lokeve shqiptare". Në restorantin "Kanina" mund të gjeni ushqime, si: flija të gatuara në mënyrën tradicionale, me saç, suxhuk në tavë, fasule në vegsh dhe shumë ushqime të tjera tradicionale. Pos këtyre, po ashtu edhe pijet janë të gjitha vendore dhe tradicionale, duke filluar nga uji, lëngjet, verërat dhe rakia.

Restoranti në fjalë mbetet impresionues sidomos për vizitorët e huaj.

Restoranti "Kanina" është hapur më 28 nëntor të vitit të kaluar. E ka marrë këtë emër nga një monument i trashëgimisë kulturore në Kaninë, rrethi i Vlorës. Pronar i këtij restoranti është ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Ismet Mulaj, i cili ishte edhe drejtor i Odës së Afarizmit të Kosovës. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ka dashur që me anë të kësaj veprimtarie t'i promovojë dhe t'i përkrahë prodhuesit, fermerët dhe bujqësitë e Kosovës. "Emrin 'Kanina' e kam marrë nga Kalaja e Vlorës. Këtë emër e gëzon edhe vajza ime. Kam dashur që pak Vlorë të sjell në Prishtinë. Qëllimi ishte të kemi një restorant familjar, me ushqime dhe produkte tradicionale të cilat janë konsumuar gjatëhistorisë. Ushqimet në restorantin 'Kanina' tani përpunohen dhe shërbehen në mënyrë moderne dhe i përkasin tradicionales, si tava e çobanit, salca e kosit e Shqipërisë, djathi i pjekur, kaçamaku me suxhuk, varianti i Dukagjinit. Këto janë disa ushqime që nuk i gjen në restorantet e tjera. Kam menduar që të marr një pjesë të ushqimeve të Dukagjinit dhe një pjesë të ushqimit nga zonat e tjera", është shprehur Mulaj.

Ai ka thënë se të gjitha ushqimet gatuhen në mënyrë tradicionale. "Për shembull, trofta e Istogut gatuhet me prush, mishi i qengjit po ashtu me prush, buka piqet në furrë me dru. Janë një sërë elementësh tradicionale që e bëjnë ushqimin të dalë tradicional. Të gjitha produktet dhe pijet janë nga trevat shqiptare", ka thënë Mulaj, duke shtuar se si ish-ministër i Tregtisë dhe Industrisë e di vlerën dhe promovimin e prodhimeve vendore. "Unë kam vendosur promovimin dhe përkrahjen e prodhimeve vendore në të mirë të vendit, pasi si ish-ministër i Tregtisë dhe Industrisë e di se ka prodhime të mira vendore dhe i kam gjetur ato më të mirat. Marrë produkte nga e gjithë Kosova dhe janë mjaft cilësore", u shpreh ai.

Mulaj ka treguar se është mirëpritur mirë nga klientët veprimtaria e tij. "Ka pasur raste kur kanë kërkuar 'Coca-Cola' dhe ujë të ndryshëm, por jo vendor. Ne u kemi thënë se shërbejmë vetëm prodhime vendore. Klientët e kanë mirëpritur këtë. Ka pasur raste edhe kur janë çuditur, për faktin se u është dukur interesant se gjithë ky restorant ka vetëm prodhime vendore. Për ushqimin tradicional furnizohemi nga familje të ndryshme shqiptare. Fasulen e marrë nga një fshat i Istogut, po ashtu edhe miellin nga Vrella e Istogut, suxhukun nga fshati Zallq i Istogut, kurse troftën nga trofta e Istogut. Mishin e marrim nga 'Buquku' në Pejë. Ndërsa pulat nga një fshat i Novoberdës, mishin e qengjit nga Malisheva, djathin dhe kosin nga qyteti i Pejës. Në përgjithësi kam krijuar klientelën time dhe kam targetuar bujqit dhe fermerët në Kosovë", u shpreh Mulaj.

Ai ka thënë se furnizimet natyrale cilësore kanë kosto. "Te ne nuk ka mish Brazili apo mazë hopla. Këto janë të lira dhe të rrezikshme për shëndetin e njeriut", ka thënë Mulaj. Ai ka treguar se tani ka krijuar një klientel të rregullt që i pëlqen ushqimet tradicionale. "Kam klientë të rregullt, në veçanti për kaçamakun me suxhuk që s'bëhet me ujë, por me qumësht dhe djathë. Kam sjell, po ashtu, pjata të stilit tradicional, si dhe sofra dykatëshe", ka deklaruar ai.

Mulaj ka thënë se ka qenë i vetëdijshëm për koston oportune të kësaj veprimtarie, por ka pohuar se ka besim te prodhimet vendore. "Kam pasur klientë edhe nga elita politike, nuk është që kanë qenë shumë të entuziazmuar, por u është dukur interesant. Unë kam besim në prodhime vendore dhe nuk e ndërroj 'Golden Eagle' me 'Red Bull', ujin 'Rugova' me ndonjë ujë tjetër apo birrën 'Peja' me 'Lasko' apo ndonjë tjetër", u shpreh ai.

Mulaj ka folur edhe për vendimin e Qeverisë së Kosovës për taksën 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës, për të cilën gjë ka thënë se nuk ka ndikuar në veprimtarinë e tij, pasi produktet e këtyre shteteve dhe të tjerave shtete të Ballkanit dhe të Evropës nuk shërbehen në restorantin e tij. "Në saje të promovimit të birrës 'Daka' në restorantin tim, tani kjo birrë do të eksportohet në Korenë e Jugut", ka thënë pronari i restorantit "Kanina", Ismet Mulaj.

Nga sot pritet t'i marrin pagat të gjithë punëtorët e 'Trepçës'

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 MARS - Deri më tani vetëm punëtorët e Minierës me Flotacion në Stan Tërg i kanë marrë pagat e muajit të kaluar, por jo edhe ata të njësive të tjera biznesore në "Trepçë". Lajmin e ka bërë me dije për "Epokën e re" kryetari i Sindikatës së "Trepçës", Shyqyri Sadiku.

Kryesuesi i bordit të ndërmarrjes "Trepça", Ardian Syla, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ka pasur para nga mjetet e prodhimit vetëm për pagat e Minierës me Flotacion në Stan Tërg.

Syla ka bërë me dije se nga sot (e hënë), kur parashihet që të transferohen paratë nga buxheti i shtetit, do të bëhen pagesat për të gjithë punëtorët e "Trepçës". "Më 14 mars kemi nënshkruar me ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, një marrëveshje me të cilën 'Trepça' përfiton si tërësi rreth pesë milionë euro, një pjesë e tyre është për subvencione me transferime, kurse pjesa tjetër është për investime kapitale por që, për shkak të procedurave, ende nuk kanë dalë në linjën e 'Trepçës'. Ne jemi në pritje dhe besoj se të hënën do të përfundojë kjo çështje dhe mandej bëhet pagesa edhe për punëtorët e njësive të tjera për muajin e kaluar. Kjo ndarje që ka ndodhur vetëm për minierat me flotacion në Stan Tërg ka qenë veprim i menaxhmetit i pakonsultuar me bordin dhe i ka bërë pagesat për aq sa ka pasur mjete në dispozicion dhe pagesa për ta është bërë prej mjeteve të prodhimit. Më së largu të hënën ose të martën do të bëhet shpërndarja e të gjitha pagave", ka thënë Syla.

Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve në "Trepçë", Shyqyri Sadiku, ka thënë se vetëm punëtorët e Minierës së Stan Tërgut i kanë marrë pagat deri më tani, kurse të gjithë punëtorët e njësive të tjera ende nuk i kanë marrë. "Punëtorët e 'Trepçës' ende nuk i kanë marrë pagat në tërësi, pasi të premten u janë dhënë pagat vetëm punëtorëve të Minierës së Stan Tergut, ndërsa të gjitha njësitë e tjera, duke përfshirë edhe Minierën e Artanës dhe Kishnicës, nuk i kanë marrë pagat. Ne nuk i dimë arsyet pse është bërë kjo ndarje kur dihet që është nënshkruar marrëveshja në mes të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe kryesuesit të bordit për subvencionim të 'Trepçës' dhe është bërë alokimi i mjeteve nga buxheti i Republikës së Kosovës diku rreth pesë milionë euro. Ne Sindikata e 'Trepçës' e kundërshtojmë këtë ndarje në mënyrë të padrejtë që dikujt t'i jepet paga e dikujt jo. Nuk ka ndonjë arsye të bëhen këto ndarje. Në të gjithë jemi punëtorë të 'Trepçës' dhe duhet të trajtohemi në mënyrë të barabartë", ka thënë Sadiku për gazetën "Epoka e re".

Mosanëtarësimi në ETNOS, Kosova humbet rreth 300 milionë euro

PRISHTINË, 17 MARS - Mosanëtarësimi në Rrjetin Energjetik Evropian i ka shkaktuar Kosovës humbje rreth 300 milionë euro që nga paslufta, mjete që i ka përfituar Serbia. Serbia nga ky rrjet për çdo vit fiton nga 17 milionë euro.

Anëtari i Bordit të Odës së Afarizmit të Kosovës, Hamdi Malushaj, ka deklaruar se, përveç humbjeve të mëdha materiale, Kosova nuk po arrin ta shfrytëzojë as interkoneksionin 400 kw me Shqipërinë, që ka kushtuar 33.5 milionë euro. "Është diku 17 milionë euro në vit të hyra direkte për Serbinë ose humbje direkte nga ana jonë. Efekti sekondar është shumë më i madh", ka thënë Malushaj. (ksp)

Vriten dy persona dhe plagoset një tjetër në Suharekë

SUHAREKË, 17 MARS (ER) - Në Komunën e Suharekës të dielën kanë ndodhur dy vrasje dhe një plagosje. Lajmin e ka konfirmuar në një konferencë për medie drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e Prizrenit, Nexhmi Krasniqi. Ai thënë se për rastin e parë bëhet fjalë për vrasjen e një 35-vjeçari me inicialet J. A nga fshati Mushtisht i Suharekës, i cili dyshohet të jetë vrarë nga rreshteri policor me inicialet Sh. S. "Diku në orën 9:47 minuta stacioni policor në Suharekë është informuar se në rrugën 'Skënderbeu'... ndodhet në person i shtrirë në një lokal (kazino), i cili punon 24 orë. Pastaj me të marrë informatën stacioni policor, i është qasur menjëherë rastit bashkë me ekipin e emergjencës, ku kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe është kuptuar edhe nga mjekët e ekipit të emergjencës se bëhet fjalë për një person i cili është vrarë me armë zjarri", ka thënë Krasniqi.

Më tutje, Krasniqi ka bërë me dije se me urdhër të prokurorit është arrestuar rreshteri policor si dhe është konfiskuar një armë, pajisjet policore dhe disa telefona celularë. Ndërsa për vrasjen e dytë, Krasniqi ka thënë se bëhet fjalë për gjuajtje me armë në mes të dy vëllezërve në fshatin Studenqan, ku ka mbetur i vdekur personi 54-vjeçar me inicialet I. B. dhe është plagosur një grua. "Bëhet fjalë për dy vëllezër, pas një konflikti të çështje pronësore", është shprehur Krasniqi. Ai ka thënë se të dy kufomat janë dërguar për obduksion në Institutin e Mjekësisë Ligjore, ndërsa gruaja e plagosur gjendet në spitalin e Prizrenit për trajtim mjekësor.

Xhemajl Hazizi zgjedhet kryetar i Rinisë së Nismës Socialdemokrate

PRISHTINË, 17 MARS (ER) - Me pjesëmarrjen e rreth 700 delegatëve, Nisma Socialdemokrate ka mbajtur Kuvendin e II Zgjedhor të Rinisë. Kryetari i Nismës, Fatmir Limaj, ka uruar kryetarin e ri të Rinisë së Nismës, Xhemajl Hazizin, të cilit i ka uruar punë të mbarë. "Rinia e Nismës ishte promotore e suksesit tonë në këta pesë vjet. Pesë vjet më parë, me një përkushtim të madh, krijuam rininë e Nismës, e cila fuqizoi partinë, duke i dhënë sukses e shpirt platformës sonë politike. Pesë vjet më parë askush nuk ka menduar që kaq shpejt mund të arrijmë këtu ku jemi", ka thënë Limaj, duke shtuar se sot Kosova është shtet i pavarur dhe i konsoliduar. "Kosova pret të rinjtë t'i marrin përgjegjësitë shtetërore. Shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim për të gjithë të rinjtë tanë të cilët, pavarësisht prej sfidave dhe vështirësive, nuk u ndalën asnjëherë së punuari e angazhuari në funksion të rritjes dhe fuqizimit të partisë sonë. Falënderim të veçantë për kryetarin e deritashëm të rinisë, Albert Maxhunin, dhe të gjitha strukturat drejtuese të rinisë", ka deklaruar Limaj.

Hapet Panairi i Bizneseve të Grave në Prizren

Kryetari i Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka thënë se ky panair është hapur me qellim të fuqizimit të gruas dhe ndikimit të saj në shoqëri. "Duke e ditur se problemi kryesor në prodhimtarinë vendore është plasimi i produkteve dhe shitja e tyre, sot me anë të panairit të organizuar me produktet vendore synojmë që sadopak të japim shtytje forcimit të bizneseve vendore.

PRIZREN, 17 MARS (ER) - Komuna e Prizrenit ka hapur Panairin e Bizneseve të Grave. Në hapje të këtij panairi, përpos kryetarit të Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka marrë pjesë edhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, dhe disa deputetë të kësaj lëvizje. Me këtë rast, kryetari i Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka thënë se ky panair është hapur me qellim të fuqizimit të gruas dhe ndikimit të saj në shoqëri. "Duke e ditur se problemi kryesor në prodhimtarinë vendore është plasimi i produkteve dhe shitja e tyre, sot me anë të panairit të organizuar me produktet vendore synojmë që sadopak të japim shtytje forcimit të bizneseve vendore. Ky panair po organizohet në veçanti për bizneset e grave nga mbarë Kosova, me qëllim të fuqizimit të gruas dhe ndikimit të saj në shoqëri. Panairi do të jetë i hapur për dy ditë në Sheshin e Lidhjes dhe gjatë kësaj kohe ftoj të gjithë qytetarët që ta vizitojnë këtë panair dhe të kontribuojnë për zhvillimin e prodhimtarisë vendore", ka thënë Haskuka.

Taksa dhe reciprociteti i plotë, çelësi i marrëdhënieve Kosovë - Serbi

Blerim MURIQI

Taksa tashmë ka treguar dimensionin shtetëror. Ajo do të duhej të bëhej temë e dialogut për t'i ndihmuar kapacitetet tona dialoguese dhe politikat tona të jashtme karshi vullgaritetit serb. Me Serbinë nuk është dashur të bisedohej përveçse për të pagjeturit dhe përmes faktorëve ndërkombëtarë. Kërkimfalja dhe njohja nga Serbia mund të përbënin bazën nisëse të fillimit të komunikimit si fqinjë, edhe pse armiqësorë. Është e padrejtë të tentohen bisedime miqësore e besueshmërie me armikun tënd. Serbia nuk ka lëvizur për asnjë temë nga qëndrimet e shtetit fashist të Millosheviqit. Ajo po mbahet larg Kosovës me forcat ndërkombëtare. Po kjo Serbi në një rrethanë tjetër tashmë do të gjendej në luftë me ne.

Ajo duke mos kërkuar falje dhe duke mos u penduar për gjithë ato që na i ka bërë me vrasjet, dhunimet dhe deportimet, ka dëshmuar se ka mbetur po ajo millosheviqistja që ishte edhe në të shkuarën. Bashkësia ndërkombëtare e shtyri Kosovën përtej dhimbjes së saj në një dialog të kuptueshëm dhe kjo e trimëroi Serbinë. Bashkësia ndërkombëtare do të duhej të ishte më e prerë me Serbinë dhe politikat e saj agresive. Duke e mbajtur gjallë agresivitetin serb, toleranca e bashkësisë ndërkombëtare ka bërë gabime dhe ato po na çojnë në rishikime territoriale. Ky do të bëhet mësimi i dhimbshëm i historisë sonë në pritje për t'u përsëritur.

Taksa së cilës do të duhej t'i shtohej edhe reciprociteti në të gjitha sferat, deri edhe në trajtimin e minoriteteve respektive, do të bënte që Serbia të kuptonte se nuk ka më letargji as shqiptare e as ndërkombëtare. Një këndellje e tillë do t'i krijonte të gjitha parakushtet e fillimit të të kuptuarit nga secili se koha e së keqes ka mbaruar njëherë e mirë.

Gërshërët në veriun e Kosovës provokojnë zhbërje shtetesh

Vitet e pas Luftës së Dytë Botërore, përveçse për shqiptarët, për tjerët në ish-Jugosllavi mund të kenë qenë kohë shprese. Vitet e dekadat rrodhën me shumë zhvillime. Beogradi u mbrujt me shovinizmin e tij serb, me çka të gjithë i bëri armiq po aq sa i kishte shqiptarët që në pushtimin e tyre. Titoja për ta bërë dreqin edhe me brirë në kurriz të shqiptarëve krijoi Republikën e Maqedonisë dhe Vojvodinës, një krahine joserbe në popullim, u arrit t'i ndërrohej struktura e saj. Popullimi i saj me serb u bë nën trysninë e pranueshme të largimit të popullatës gjermane atje si fajtor kolaborimi me nazizmin.

Sanxhaku mori rrugën asimiluese në drejtimin e fesë, po nuk u bë serb. Myslimanizimi i tij, megjithatë, ruajti kujtimin për masakrat serbe në trevë. Mali i zi shpëtoi meqë Serbia besonte në vëllazërinë sllave, të cilën besonte se ia kishte arritur ta mbillte te malazezët. Ajo kishte harruar se gjaku nuk bëhet ujë.

Nëse nuk flasin plagët, flet kujtesa!

Shpërbërja e Jugosllavisë ishte domosdoshmëri raportesh ndëretnike. Ato ishin ngarkuar. Shovinizmi serb nuk po e kontrollonte veten. Beogradi u bë magjja ku gatuhej shovinizmi dhe prej ku shkëndijat e luftërave e krimeve shpërndanë federatën. E fundit ndër to u shkëput Kosova, edhe pse ajo duhej të ishte e para në atë zhvillim. U desh që bashkësia ndërkombëtare të na ndihmojë ushtarakisht duke e bombarduar Serbinë për ta realizuar, të paktën, minimumin human që kishin në themelet e saj kombet e bashkuara.

20 vjet pas kësaj sot Kosova po rrezikohet të futet nën thikat serbe për territoret e saj. Është e çuditshme se si disa nga shpëtimtarët e djeshëm po flitet se po e dërgojnë Kosovën në këtë gijotinë. Ata që po e dërgojnë Kosovën në gijotinën e territoreve, po harrojnë se rajoni jonë ka nevojë më shumë për paqen sesa për armiqësitë e reja. Më shumë ka nevojë për ta konservuar të tashmen sesa t'i ushqej apetitet e ndarjeve etnike, të cilave asnjëherë nuk do t'u gjendet fundi. Nëse Bashkimi Evropian është synimi i rajonit atëherë çdo lëvizje territori sot është shtyrja e këtij integrimi të paktën për 20 deri në 30 vjet. Kujt po i intereson kjo?

Kosovës mund t'i preken kufijtë dhe kjo nuk do të prodhojë luftë sot e derisa të jenë ndërkombëtarët këtu, veçanërisht amerikanët, por kjo nuk mund të thuhet për rajonet e tjera. Vojvodina, Sanxhaku i mbetur nën Serbi, serbët dhe kroatët e Bosnjës do ta kenë vështirë të mos e ndajnë Bosnjën. Po kësaj rruge do të provojnë të shkojnë serbët në Mal të zi. Po Maqedonia! Shqiptarët do ta donim kështu sikur është të tërën për vete, por ka edhe interesa të tjera atje.

Rusia në gjithë këto vite është angazhuar shumë për ta goditur Malin e Zi dhe aspiratën e tij për të mos u përfshirë në pansllavizmin rus. Ajo duket se po punon atje me elementin serb. Këtë ka provuar jo më pak edhe me Maqedoninë sikur që po e provon ta destabilizojë tashmë Shqipërinë. Në rrethanë të tillë Maqedonia, si pika nevralgjike e rajonit dhe kodi i pranueshëm i të gjithë nacionalizmave rajonalë, rrezikon të bëhet arenë shërbimesh inteligjente dhe përplasje nacionalizmash.

Nëse në Kosovë do të vendoset me çelësin: pse të jetojnë serbët e veriut me shqiptarët në Kosovë dhe pse Lugina e Preshevës në Serbi, atëherë gjithë popujt e rajonit nuk do të kenë apo duan të mos kenë përse të jetojnë me shtetet ku sot janë dhe popujt me të cilët i ndajnë hapësirat e përbashkëta. Ndarja e të pandarave është vetë konflikti. Forcat ndërkombëtare mund t'i mbajnë këto konflikte potenciale të ngrira, por motet do t'i shkrijnë këta akuj fatkeq të mbushur me gjak e fatkeqësi. Ne do jemi ata që do t'ia japim fëmijët tanë kësaj kuçedre që po na e përgatisin këto mendje të luajtura.

Nëse ky çelës është fati i rajonit tonë atëherë le të mendohet edhe pak e le të gjendet zgjidhja, e cila nuk na lë në gjysmë të rrugës prej ku vetëm luftëra e gjak do të ketë.

Ndarja etnike edhe mund të bëhet çelësi i rajonit, edhe pse kishim besuar se bota njerëzore është emancipuar më shumë sesa për të qenë e denjë për vlera segregacioniste. Në rast se kjo është dhurata që bashkësia ndërkombëtare dëshiron të na japë si zgjidhje të imponuar, të paktën le të mendojnë tërësinë e aksionit ku bashkë me territoret t'i lëvizin edhe popullsitë dhe t'i imponojnë kufijtë e luftës së ftohtë në 50 vjetët e ardhshëm.

Nuk besoj në sigurinë e një kishe shqiptare të grabitur nga shteti dhe historiografia serbe e cila është në territor shqiptar dhe se mund t'ua imponojë kush shqiptarëve që ajo akoma të mbetet serbe në paqenësinë e saj dhe të mos i kthehet pronarit legjitim, praktikantit të ritit përkatës shqiptar. Po ashtu, nuk besoj në paqen e miqësinë e popujve të bartur në shtëpitë e njëri-tjetrit. Forca i mban në një burg edhe dy armiq sikur mbajti komandantët tanë me kriminelët serbë në Hagë, por liria nuk do t'i bashkojë kurrë veç nëse rastësia do t'u jepte kënaqësinë ta vrisnin njëri-tjetrin.

Maqedonia është e brishtë dhe ajo më në fund po e gjen rrugën integruese nga brenda e nga jashtë, por për t'u prishur i mjafton vetëm nga brenda dhe nuk e mbron dot askush nga jashtë. Kjo formulë shkatërrimtare e zhbëri Bashkimin Sovjetik e Paktin e Varshavës, Jugosllavinë e gjithë lindjen. Kjo formulë fatkeqe për shtetet, por shpëtimtare për popuj, po e çon Spanjën në pranueshmëri ndarjeje ku katalonasit që e meritojnë lirinë e tyre, edhe ta gëzojnë.

Baskët, flamanët e kushdo popull e krahinë kanë mijëra arsyeja për të mos mbetur të pushtuar etj. Pse do të duhej që Tiroli i jugut të mos bënte hapat e ëndrrës së tij, ku do të lindte pyetja më kapitale e zhbërjes së Evropës?

Ne në Ballkan kemi luajtur mjaft me zjarrin!

Kushdo që mund të kuptojë se ku po futet do të bindet një ditë se loja me kufijtë është vetë gaca e pambuluar që do të duroj kujdestare për ta ndezur zjarrin e luftërave tona të ardhshme.

Shqiptarët dhe Serbët kanë shumë për të rregulluar mes vete dhe ato duhen bërë në kohë të tjera kur të largohemi nga era e gjakut.

Është mirë mos ta lodhim historinë!

Askush nuk është imun nga sherret!

Mbi 200 ankesa presin zgjidhje për emërtimet e rrugëve në Malishevë

MALISHEVË, 17 MARS (ER) - Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Emërtimet e Rrugëve si dhe Emërtime të reja ka mbajtur mbledhje, e cila është drejtuar nga Rrahim Morina, ku pikë e rendit të ditës ishte zgjedhja e kryesuesit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Emërtimet e Rrugëve si dhe Emërtime të reja.

Me shumicë të votave kryesues i këtij komisioni u zgjodh Ali Morina, i cili, pas pranimit të detyrës, ka kërkuar nga anëtarët bashkëpunim të plotë në këtë komision pasi, sipas tij, i pret një punë e madhe për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve.

Në këtë mbledhje është bërë me dije se mbi 200 ankesa e presin për zgjidhje Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave për Emërtimet e Rrugëve si dhe Emërtime të reja. Në fund, komisioni ka njoftuar qytetarët se afati për kërkesa dhe ankesa do të mund të bëhet nga dita e hënë deri në ditën e premte (nga 18 mars deri më 22 mars).

Senatorja Kristen Gillibrand fillon fushatën presidenciale

Uashington, 17 mars - Senatorja demokrate Kirsten Gillibrand e Nju Jorkut filloi fushatën presidenciale në përpjekje për të siguruar emërimin e partisë së saj përballë presidentit Donald Trump në zgjedhjet e vitit 2020.

Ajo filloi zyrtarisht fushatën të dielën jo me ndonjë fjalim të madh por duke lëshuar një video që shtron pyetjen "A do të fitojë guximi?" "Na duhet një udhëheqës që të bëjë zgjedhje të mëdha dhe të guximshme, dikush që nuk ka frikë nga përparimi", thotë ajo.

Senatorja Gillibrand pritet ta mbajë fjalimin e parë të rëndësishëm javën e ardhshme para Hotelit Trump International në Nju Jork. Ajo dha një ide të çështjeve te të cilat do të përqendrohet kur foli për kujdes shëndetësor universal, leje të paguar për arsye familjare, nevojën për kontroll të armëmbajtjes, miratimin e një plani të gjelbër, dhe për rimarrjen e demokracisë.

Gillibrand hyn në radhët e një grupi të madh kandidatësh demokratë, që përfshin mes të tjerësh disa nga anëtaret e tjera të Kongresit si Elizabeth Warren, Amy Klobuchar, Kamala Harris dhe Tulsi Gabbard.

Sulmuesi në Zelandën e Re ka vepruar i vetëm

Policia e Zelandës së Re thotë se personi që është akuzuar për sulmet në dy xhami të premten ku mbetën të vrarë 50 persona, besohet se ka vepruar i vetëm

Wellington, 17 mars - Personi që është akuzuar për sulmet në dy xhami të Zelandës së Re të premten, besohet se ka vepruar i vetëm, tha policia. Australiani Brenton Tarrant, 28 vjeç, që e ka përshkruar veten si supermacist i bardhë, kishte postuar në "Facebook" videon e sulmit dhe një manifest, ku shprehte pikëpamjet e tij kundër myslimanëve.

Edhe tre persona ishin arrestuar pas sulmeve në dy xhamitë, ku mbetën të vrarë 50 persona. Por, sipas komisionarit policor, Mike Bush, ata besohet se nuk kanë qenë të përfshirë në këto sulme, raporton BBC.

Nderimet për personat e vrarë kanë nisur, teksa pritet që trupat e pajetë të viktimave t'u dorëzohen familjarëve për varrim.

Rreth 34 persona të tjerë vazhdojnë të marrin trajtim mjekësor, pasi kanë pësuar lëndime nga armët e zjarrit. Një vajzë katërvjeçare vazhdon të jetë në gjendje kritike, ka njoftuar rfe.

Kryeministrja e Zelandës së Re, Jacinda Ardern, tha se kabineti i saj do të diskutojë për reformat mbi politikat për armët sot (e hënë), duke përsëritur se do të "ketë ndryshme në ligjet tona për armët".

Duke folur me gazetarët të dielën, ajo tha se Parlamenti gjatë ditës së martë do t'i nderojë viktimat, e asaj që ajo e cilësoi si "akt të terrorit", dhe shtoi se pret që trupat e pajetë të viktimave t'u kthehen familjarëve të mërkurën.

Kryeministrja Ardern konfirmoi se zyra e saj kishte pranuar një dokument nga sulmuesi i dyshuar, vetëm nëntë minuta para se të nisnin sulmet, por tha se aty nuk përfshihej ndonjë detaj specifik, siç do të mund të ishte lokacioni i sulmit. Ajo shtoi se ky dokument u ishte përcjell shërbimeve të sigurisë pas dy minutash.

Ndërkaq, zyrtari policor Bush, tha se autoritetet janë duke punuar sa më shpejt që është e mundur për t'i identifikuar të gjitha viktimat e sulmit në xhaminë Al Noor dhe Linvood të qytetit Kristçërç. Ai shtoi se ky proces është i ndjeshëm dhe se ai është i "vetëdijshëm për aspektet kulturore dhe fetare".

I dyshuari i sulmeve, Tarrant është paraqitur të shtunën pranë një gjykate, ku zyrtarisht është akuzuar për vrasje. Autoritetet kanë thënë se ndaj tij mund të shtohen edhe akuza të tjera. Ai do të qëndrojë në paraburgim deri në paraqitjen e radhës në gjykatë, që është caktuar më 5 prill.

Ndërkohë, disa shtete kanë filluar të konfirmojnë se në mesin e të vrarëve në Kristçërç janë shtetas të tyre.

Pakistani ka konfirmuar se në mesin e viktimave janë nëntë shtetas të tij, ndërkaq, Ambasada e Afganistanit në Zelandë të Re, ka thënë se tre afganë janë në mesin e të vrarëve.

Po ashtu, në mesin e të vrarëve ka edhe shtetas të Bangladeshit, Turqisë, Arabisë Saudite, Jordanisë, Indonezisë, Malajzisë, Egjiptit dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Një dokument, ku janë listuar viktimat e dy sulmeve më 15 mars, tregon se viktimat ishin nga tre deri në 77 vjet.

May heq dorë nga votimi për herë të tretë i marrëveshjes për Brexitin

Londër, 17 mars -Kryeministrja britanike, Theresa May mund të heqë dorë të kalojë për herë të tretë në votimin e deputetëve marrëveshjen e tërheqjes që ajo negocioi me Bashkimin Evropian, nëse nuk siguronte mbështetjen e nevojshme, deklaruan të dielën dy nga ministrat e saj. "Nuk është e sigurt nëse do të ketë votim", u shpreh për BBC-në, ministri i Financave, Philip Hammond. Ne do të prezantojmë marrëveshje të re vetëm nëse jemi të sigurt që një numër i mjaftueshëm i kolegëve tanë dhe i DUP-së janë të gatshëm për ta mbështetur atë që të kalojë në parlament. "Kjo do të varet nga aftësia jonë për të fituar këtë votim në Dhomën e Komuneve", deklaroi ministri për Tregtinë Ndërkombëtare, Liam Fox, pasi theksoi se do të ishte e vështirë të justifikohej organizimi i një votimi nëse është i sigurt dështimi.

Teksti u kundërshtua më 15 janar me 432 vota kundër dhe 202 pro, më pas të martën nga 391 vota kundër dhe 242 pro.

Kryeministrja po përpiqet t'i bindë euroskeptikët e ashpër të partisë së saj dhe deputetët e partisë së vogël së Irlandës së Veriut, DUP aleaten e saj në parlament, të cilët e konsiderojnë marrëveshjen e saj shumë pajtuese me Brukselin, për të ndryshuar qëndrim.

Caputova, fituese në raundin e parë të presidencialeve në Sllovaki

Bratislavë, 17 mars - Kritikja e qeverisë, Zuzana Caputova siguroi një fitore të konsiderueshme ndaj kandidatit të partisë në pushtet në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale në Sllovaki, një hap që e bën pothuajse të sigurt zgjedhjen e saj si e para presidente grua e vendit.

Rezultatet zyrtare tregojnë se Caputova ka siguruar mbi dyfishin e votave të rivalit të saj Maros Sefcovic, një shenjë se elektorati ka refuzuar klasën tradicionale politike, pas vrasjes tronditëse vitin e kaluar të një gazetari hulumtues i cili po hetonte korrupsionin.

Avokatja e mjedisit, një liberale, që siguroi 40 për qind të votës shkon tani drejt raundit të dytë në garën me nënpresidentin e Komisionit Evropian, Sefcovic, që mori vetëm 19 për qind të votës.

Rezultati ka gjasa të sinjalizojë një rënie për partinë në pushtet Smer-SD para zgjedhjeve të përgjithshme të viti të ardhshëm.

BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.

Komandanti zemërshqiponjë Enver Zymer Avdyli-Rafuna, njeriu i përkushtimit atdhetar gjithëkombëtar

Komandanti i mirënjohur i tri luftërave atdhetare çlirimtare në Kosovë dhe i luftës në Kroaci, Enver Avdyli-Rafuna, nuk ndalet dot së vepruari dhe së punuari për paqen dhe për t'i ndihmuar skamnorët në Kosovë dhe kudo në trojet shqiptare... Vetëm gjatë tri vjetëve të fundit Shoqata Humanitare "Diaspora", drejtor i së cilës është Enver Rafuna, ndërtoi dhe ua fali skamnorëve 54 shtëpi në fshatra, qytete dhe vendbanime të ndryshme të Kosovës dhe të Shqipërisë. Humaniteti i thellë i komandant "Hoxhës" dje në luftë e sot në liri, vazhdon

Shkruan: Afrim MUSTAFA, *ish-reporter dhe veteran i luftërave të UÇK-së*

Emrin e Enver Avdyli Rafunës e kam dëgjuar disa herë nga bashkëveprimtarët dhe bashkëluftëtarët e shumtë të atdheut tonë. Në fakt, Enveri ishte një nga organizatorët e shkëlqyeshëm të luftërave të UÇK-së në tri hapësirat shqiptare, si dhe fillimisht çlirimtar dhe organizator, edhe i luftës në Kroaci. Duke u ndihmuar atje miqve tanë kroate për ta shporrur njëherë e përgjithmonë armikun gjakatar nga trojet e tyre. Enver Avdyli-Rafuna sot ka një autoritet të veçantë, të cilin, gjatë veprimtarisë së tij atdhetare, heroike e çlirimtare, e krijoi me mund e përkushtim të thellë. Por, ai këtë autoritet edhe me shumë e trashëgoi nga familja, po ashtu kontribuuese e thellë për lirinë dhe për pavarësinë e Republikës së Kosovës në momentet më të vështira dhe më krenare, njëkohësisht.

Baca Zymer Avdyli- Rafuna, babai i komandantit dhe atdhetarit Enver Zymer Avdyli-Rafuna, po ashtu ishte një atdhetar, trim, burrë, bukëdhënës dhe njeri shumë humanitar. Historia e lavdishme dhe krenare e pajtimeve të gjaqeve, aksion zulmëmadh, i realizuar nga viti 1990-1992 nuk mund të shkruhet dhe dokumentohet pa veprimtarinë atdhetare, humanitare dhe pajtimtare të bacës së veçantë, Zymer Avdyli-Rafuna, i cili me bashkëveprimtarët e tij shoi shumë konflikte, ndërmjetësoi dhe i zhduku plot e përplot ngatërresa, vrasje e plagosje nëpër rajone të ndryshme të territorit të Republikës së Kosovës, e pushtuar dhe e okupuar për qindra vjet nga gjenocidi serbosllavomadh dhe serborusosllav.

Anton Çeta, kryepajtimtari i madh i maleve dhe i njerëzve nëpër malet dhe bjeshkët e Kosovës, e kishte një krah të djathtë dhe zemër të tijën, plakun, mendimtarin dhe atdhetarin e përkushtuar dhe me autoritet në këto troje, Zymer Avdyli-Rafuna, një burrë i ndershëm, mendjendritur dhe fjalëpakë, por veprimtar i thellë i atdheut. Baca Zymer, i ardhur në Hajvalinë e qëndresës gjithëkombëtare nga krahina e Gollakut, përkatësisht nga Kremenata e Kamenicës kryengritëse, barti në vetvete, dinjitetin, humanitetin dhe bamirësinë, të cilën nuk do ta ndalë asnjëherë.



Shpeshherë, plaku i maleve të Karadakut e të Gollakut kishte marrë respektin e thellë nga i madhi Anton Çetta, i cili kishte thënë se bacën Zymer e ka në shpirt, në zemër dhe në hapat gjigantë, për t'i nderuar dhe pajtuar e afruar shqiptarët kudo në trojet shqiptare.

Zymer Avdyli-Rafuna, Anton Çetta, Zekeria Cana, Bejtullah Kçiku, Mulla, Idriz Kakrruki, Don Lush Gjergji, ishin bërë si një zemër dhe si një emër dhe shkonin aty ku kishte nevojë dhe domosdo për t'i nderuar, pajtuar dhe afruar shqiptarët.

Aksionet e Anton Çettës, Bacës Zymer, Zekerijahut, Don Lushit, Mulla Idrizit, Behram Hotit dhe qindra atdhetarëve e bashkëveprimtarëve të tjerë nuk i ndalnin dot, as shiu, as furtuna, bora dhe acari. Ata vepronin, punonin dhe pajtonin mal me mal, kodër më kodër, shtëpi më shtëpi, avli më avli dhe kudo, ku kërkohej… Aksionet e thella të këtyre trimave heronj dhe bashkues të shqiptarëve nuk u shkonin përshtati, kurrsesi, pushtuesve famëzinj serbosllavë, të cilët Zymeri me shokë i kishin halë në sy. Sot, baca Zymer Avdyli-Rafuna është në botën e përtejshme, por kryekëput e ka trashëguar djali i tij i dytë, i cili ka themeluar dhe është drejtor shumë i suksesshëm i Shoqatës Humanitare atdhetare dhe Bamirëse, "Diaspora", me të cilën ai po jep një kontribut

Veprimtari dhe atdhetari Zymer Avdyli-Rafuna. Avdyli, 10 janar 1938, 7 prill 1997. Është babai i komandantit, Enver Avdyli-Rafuna, sot drejtor i Shoqatës Humanitare "Diaspora", me seli në Prishtinë, por e cila vepron dhe ndihmon gjithandej trojeve shqiptare

Komandant "Hoxha" - Enver Avdyli-Rafuna, gjatë luftës së UÇPMB-së në Kosovën Lindore, ku ishte epror i kësaj lavdie çlirimtare

Nexhat Ejupi, afarist nga Shtimja, përkrahës i vazhdueshëm i familjeve të dëshmorëve, luftëtarëve, invalidëve dhe, në veçanti, i shoqatës gjigante humanitare "Diaspora", udhëhequr nga drejtori i kësaj shoqate shumë humanitare, Enver Avdyli-Rafuna, i njohur me emrin e çlirimtarit Komandant "Hoxha"

shumë të thellë për t'i ndihmuar skamnorët, varfanjakët dhe krejt ata, të cilët jetojnë në kushte të rënda ekonomike, bile në mjerim të thellë…

Por, komandanti i katër luftërave, Enver Rafuna, nuk ndalet së punuari dhe së vepruari për të mirat gjithëshqiptare. Ai, sa është në Karadak, sa në Dukagjin, sa në Istog, sa në Beguncë të Vitisë, sa në Suharekë, e të nesërmen do ta gjeni në Studenicë të Istogut. Misioni i Shoqatës atdhetare gjigante Humanitare, "Diaspora", sa vije e po zgjerohet.

Por, komandanti i veprimit dhe i nderimit emblematik, asnjëherë nuk harron të përmend ata që i japin jetë, mirësi dhe gjallëri në misionin e tij, si: Veprimtarët dhe humanitarët shumë të Çmuar nga Shtimja: Vëllezërit: Hasan dhe Nexhat Ejupi, të cilët në momentet më të vështira kanë dhënë kontribut shumë të jashtëzakonshëm.

Për këta vëllezër humanitarë dhe atdhetarë, edhe një libër i veçantë të shkruhet, është pak…Por, ndihmuan edhe të tjerët, si, vëllezërit, Lazer dhe Frrok Ndue Ballabani nga Stublla, me punë në Austri. Në këtë mes, ai nuk harron të përmendë edhe veprimtarin Vesel Alshiqi, udhëheqës i Shoqatës së Tregtarëve me shumicë të Prishtinës, me emrin "Bashkimi", e cila po ashtu nën udhëheqjen e Alshiqit po ndihmon herë pas here shoqatën e mirënjohur dhe gjigante humanitare "Diaspora". Komandanti, dje i shkëlqyeshëm në luftë, e sot i shkëlqyeshëm dhe human me shoqatën e tij bamirëse, përmend për kontribut edhe veprimtarinë e shquar dhe të veçantë: Shefqet Baca nga Lismiri i Obiliqit, i cili gjithashtu me zemër ndihmon shoqatën e drejtuar nga drejtori i pazëvendësueshëm, Enver Avdyli-Rafuna, komandant "Hoxha". Dhe, komandanti i mirënjohur i atdheut, dje i luftës, e sot i humanitetit gjithandej trojeve shqiptare, Enveri nuk harron pa përmendur as edhe veprimtarin e njohur nga Studenica e Istogut, në mërgim, Shefqet Gorcaj, i cili gjithashtu, herë pas here ndihmon dhe nderon shoqatën me humanitet dhe me bamirësi të pandalshme. Përkrahje të parezervë shoqatës së vlerave të larta atdhetare e humanitare, "Diaspora" po i japin edhe z. Zija Xheladini nga Reçaku i krenarisë kombëtare, i cili vepron dhe punon në Zvicër dhe i cili përfaqëson shoqatën në shtetin helvetik. Po ashtu, kontribut ka dhënë dhe po jep edhe veprimtari Hamit Qazim Hamiti nga Shkupi, me prejardhje nga Kabashi i Vitisë dhe i cili gjendet me punë në Norvegjinë e largët dhe mike të Kosovës.

Gjithashtu nuk ndalet së ndihmuari shoqatën e kontributit edhe veprimtari dhe atdhetari Agim Dreshaj nga Prigoda e Istogut, i cili, bashkë me bashkëshorten e tij, Valbona Beqiri-Dreshaj nga Gjermania, është krah i përhershëm i komandant "Hoxhës" dhe i shoqatës të cilën e udhëheq ai. Vepron dhe përkrah edhe Abaz Aziri nga Kosaça e Gjilanit, i cili gjendet me punë në Loudon Ontorio, në shtetin e Kanadasë. Por, kurrsesi nuk harrohet përkrahja dhe kontributi i atdhetarit të çmuar, Arben Binakaj nga Belegu i Deçanit, i cili gjendet në Zvicër. Ka shumëçka, shumë e shumë të shkruhet dhe të thuhet për shoqatën e humanitetit të veçantë të përmasave shumë të larta të përkrahjes dhe të humanizmit. Por, kësaj radhe kaq, për komandantin dje luftëtar, epror dhe çlirimtar i rrallë në katër luftërat ballkanike, në Kroaci dhe tri në Kosovë, e sot, humanitar, gjithandej shqiptarisë.

Komandant "Hoxha", Enver Avdyli-Rafuna me bashkëluftëtarët: Afrim Sejdiu, Shaban Ukshini (dëshmor) Lulzim Ibishi, Demush Demiri në UÇPMB në Magjerre, viti 2000

E jashtëzakonshme

Dëshira e 104-vjeçares: Të arrestohem nga policia

Një grua e moshuar zbuloi dëshirën e saj për t'u arrestuar sepse nuk ka kryer kurrë asnjë krim. Policia ra dakord për të 'arrestuar' 104-vjeçaren Anne Brokenbrow, e cila do të hyjë në paraburgim për herë të parë në jetën e saj. Brokenbrow, e cila punoi si sekretare para se të dilte në pension, i habiti të gjithë kur zbuloi dëshirën e saj. "Dua të arrestohem. Jam 104 vjeçe dhe nuk kam bërë asnjë krim", ka thënë ajo. Policia lokale ka njoftuar se ishin shumë të lumtur t'ia plotësonin kërkesën kësaj gruas.



FOTO E DITES

Një njeri shihet i veshur si një kalë në bulevardin e Moskës. /AFP/

E rrallë

Vrau qenin e komshiut, dënohet me nëntë vjet burgim

Një burrë, i cili i nxori syrin qenit të komshiut dhe vrau një qen tjetër me shkop bejsbolli, është dënuar më shumë se nëntë vjet burgim. David C. Herbert, një ish-punonjës i marinës, u dënua të premten për abuzimin fizik ndaj qenve të fqinjëve, duke përdorur metoda çnjerëzore, përfshirë acid dhe helm.

BARSOLETA E DITËS

Një polic shikon një fëmijë duke pirë cigare dhe e qorton:
- A e di se duhani ta shkurton jetën?, e pyet polici.
- Jo, i përgjigjet fëmija.
- Sa vjeç je?, e pyet polici.
- 10 vjeç, i përgjigjet fëmija.
E shikon dhe i thotë polici:
- Po të mos kishe nisur cigaren do të ishe 15 vjeç!

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 14:00

"SHEEP AND WOLVES" 3D



I Animuar/Aventure/Komedi; 1 ore 25 min

Rolet: Graham Halstead, Vladimir Chuprikov
Regjia: Vladimir Nikolaev

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"ALITA: Battle Angel" 3D

Aksion/Aventure/Romanse; 2 ore 02 min

Rolet: Rosa Salazar, Christoph Waltz, Jennifer Connelly, Mahershala Ali, Ed Skrein, Jackie Earle Haley, Keean Johnson, etj.
Regjia: Robert Rodriguez

Në ora 18:00

"BERLIN, I LOVE YOU"

Dramë/Romansë; 2 ore

Rolet: Keira Knightley, Helen Mirren, Luke Wilson, Mickey Rourke, Jenna Dewan
Regjia: Dianna Agron, Peter Chelsom, Claus Clausen

Në ora 20:00 dhe 22:00

""SERENITY"

Dramë/Triller; 1 orë 46 min

Rolet: Matthew McConaughey, Anne Hathaway, Diane Lane, Jason Clarke, Djimon Hounsou, Jeremy Strong, etj.

Regjia: Steven Knight

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Edhe pse do të keni shpenzime, do t'i rikuperoni shumë shpejt financat tuaja falë një investimi që keni bërë kohë më parë.

DEMI
Megjithëse ju duket sikur vendimet tuaja nuk i kanë dhënë frytet e tyre, duhet t'i prisni për t'i parë rezultatet e para.

BINJAKËT
Dita e sotme paraqitet e qetë me rutinën e zakonshme të punës ose studimit për ata që janë në shkollë. Një marrëveshje biznesi po ju intrigon.

GAFORRJA
Edhe pse i keni planetët kundër shenjës suaj sot, do të arrini t'i ekuilibroni ndjenjat dhe situatat e komplikuara që ju paraqet dita.

LUANI
Sot çdo gjë po e bëni me qejf dhe dëshirë, madje edhe ato çështje që ju janë ofruar nga puna juaj. Si për çudi, do t'i zgjidhni në një kohë të shkurtër.

VIRGJËRESHA
Jeni pak të shqetësuar me disa situata që po verifikohen në ambientin familjar. Duhet të gjeni një zgjidhje sa më parë.

PESHORJA
Edhe pse partneri duket shumë i mërzitur dhe rebel, sot do të jeni ju që do të merrni në dorë situatën dhe çdo gjë do të qetësohet.

AKREPI
Keni lenë shumë gjëra pa mbyllur në punën tuaj dhe sot do të rrini me orë të gjata në zyrë për të përfunduar.

SHIGJETARI
Edhe pse ju kanë rekomanduar një ambient të caktuar dhe njerëz të besuar, intuita juaj sot nuk do t'ju lejojë t'i ndiqni udhëzimet e të tjerëve.

BRICJAPI
Keni vendosur rregulla për mbarëvajtjen e gjërave në familjen tuaj, por ato nuk po respektohen. Do t'i kërkoni fajtorët.

UJORI
Debate të ndezura për një projekt ku pjesëmarrja është e madhe. Gjithsecili kërkon t'i marrë meritat në fushën e tij.

PESHQIT
Ju pëlqejnë pushimet në këtë stinë dhe po planifikoni një shkëputje të shkurtër që do t'ju çlodhë dhe do t'ju rigjenerojë.

Jaden Smith, me stil interesant të flokëve

Reperi Jaden Smith e ka pranuar se ka një stil të pazakontë. 20-vjeçari në një intervistë për "The Daily Telegraph" ka thënë se zgjedhjet e tij të modës janë paksa të çuditshme. "Stili im është i çmendur. Ndonjëherë e rruaj gjysmën e kokës. Jam i hutuar nga vetja ime", ka thënë Smith.

Kylie Jenner duket e bukur në të zezë

Ylli televiziv Kylie Jenner mbrëmë ka qenë në një ndejë në "The Nice Guy" në Los Anxhelos. Jenner pati të veshur pantallona të zi të cilët i rrinin shumë bukur.

Jessica Alba bën tri tatuazhe për fëmijët e saj

Jessica Alba ka bërë një tatuazh shumë të veçantë. Aktorja dhe biznesmenja e suksesshme ka postuar disa fotografi në llogarinë e vet në "Instagram" ku ka treguar se ka bërë tri tatuazhe të reja në krahun e saj të majtë. Të tri dizajnet e tatuazheve janë konstalacione të yjeve, që secili prej tyre e ka një kuptim të veçantë për themeluesen e kompanisë "Honest". "Honor, Binjakët", "Haven, Luan" dhe "Hayes, Bricjapi", ka shkruar Alba në postimin e saj. Në fakt, këta janë tre emrat e fëmijëve të aktores që kanë moshën 10, 7 dhe 1 dhe shenjat e tyre të horoskopit.

Khloe për Tristan: Ai është baba i mirë për vajzën tonë



Ylli televiziv, Khole Kardashian, para një muaji ishte tradhtuar nga i dashuri i saj, Tristan Thompson. Kështu së fundi ajo e ka lavdëruar ish të dashurin e saj, se ai është një baba i mirë për vajzën e tyre, True. Sipas "Hollywood Life", Khloe reagoi kështu pasi një adhuruese e saj i shkroi në "Twitter", duke i thënë se ajo duhet të mbajë kokën lart për vajzën e saj. "Ajo është gjithçka që ju keni". Ndërsa Khloe e falënderoi atë për këto fjalë. "Faleminderit dashuri! Je shumë e ëmbël. Por, ai është një baba i mirë për të", ka thënë Khole.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE						
	NUMANCIA - MALAGA	2	REGENSBURG - GREUTHER FURTH	GG	AJACCIO - LENS	2

Feronikeli shkatërron '89-shin, Llapi gabon ndaj Ballkanit

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 MARS - Skuadra lidere dhe favorite për titull në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, Feronikeli, ka shkëlqyer edhe në ndeshjen ndaj Trepçës '89, pasi ka fituar me rezultat bindës 5-0. Në këtë mënyrë kjo skuadër e ka bërë edhe një hap drejt titullit, kurse skuadrës nga Mitrovica i mbetet shumë punë për ta siguruar mbijetesën. KEK-u, që është skuadra e fundit në tabelë dhe tashmë e ka të sigurt rënien nga elita, është paraqitur mirë ndaj Gjilanit, por ka pësuar humbje në minutat shtesë. Ndeshja në mes dy skuadrave nga kryeqyteti, Prishtinës dhe Flamurtarit, me vendim të Federatës së Futbollit të Kosovës është shtyrë për datën 27 mars.

Feronikeli - Trepça '89 5-0

Skuadra lidere e IPKO Superligës, Feronikeli, e ka shkatërruar Trepçën '89, pasi sot e ka mposhtur në Drenas me rezultat 5-0. Mysafirët nga Mitrovica janë mbajtur vetëm deri në minutën e 29, kur Bujar Pllana shënoi autogol për 1-0. Në pjesën e dytë vendësit ishin të pandalshëm dhe realizuan edhe katër gola të tjerë. Në minutën e 47 Mendurim Hoti shënoi për 2-0, kurse dy golat e tjerë i shënoi braziliani Carioca. Rezultatin final 5-0 e vulosi sulmuesi Kastriot Rexha në minutën e 85-të.

Gjilani - KEK-u 2-0

Skuadra e KEK-ut që ka vetëm një pikë të grumbulluar në këtë edicion garash është paraqitur mirë në ndeshjen e zhvilluar ndaj Gjilanit, por ishte e pafat për faktin se pësoi humbje në minutat shtesë (2-0). Në minutën e tretë shtesë Shpend Asani realizoi për 1-0, kurse dy minuta më pas Wilber Perez shënoi për rezultatin final 2-0. Pas këtyre tri pikëve Gjilani është ngritur në pozitën e pestë me 32 pikë, kurse KEK-u edhe zyrtarisht sezonin tjetër do të bëjë gara në Ligën e Parë.

Llapi - Ballkani 1-1

Skuadra e Llapit ka bërë një hap pas në garën për titull të kampiones në elitë, pasi të shtunën ka barazuar në ndeshjen ndaj Ballkanit (1-1). Skuadra mysafire e

nisi më mirë ndeshjen dhe arriti të shënojë gol në minutën e pestë nëpërmjet sulmuesit Jetmir Topalli. Me rezultat 0-1 u mbyll pjesa e parë, kurse vendësit në pjesën e dytë ishin edhe më kërkues, kurse arritën ta barazojnë rezultatin vetëm gjashtë minuta para fundit të ndeshjes kur Mentor Zhdrella shënoi nga penalltia për 1-1. Skuadra nga Podujeva tash mbetet shtatë pikë pas skuadrës lidere, Feronikelit. Ndërsa skuadra nga Suhareka është në rrugë të mirë që t'i ikë edhe zonës së barazhit.

Drenica - Ferizaj 0-0

Ndeshja tjetër që përfundoi pa fitues ishte ajo në mes të Drenicës dhe Ferizajt, e cila u zhvillua në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj. Rastet nuk munguan në këtë ndeshje, por rezultati final mbeti ai i fillimit 0-0. Pas kësaj xhiroje Drenica është e pesta me 30 pikë, kurse Ferizaj është në pozitën e dhjetë me 25 pikë.

Drita - Liria 2-0

Drita i është hakmarrë skuadrës së Lirisë për humbjen në xhiron e tretë të këtij edicioni, pasi e ka mposhtur në ndeshjen e zhvilluar të shtunën në Gjilan (2-0). Prizrenasit kishin udhëtuar për pikë dhe u paraqitën mirë, sidomos në pjesën e parë të ndeshjes, por Drita arriti te goli i parë në minutën e 77, kur realizoi Filonit Shaqiri për 1-0. Pesë minuta më vonë Betim Haxhimusa u përkujdes për rezultatin final 2-0. Pas kësaj fitore kampionët e përforcojnë pozitën e katërt, kurse Lirisë i mbetet shumë punë për ta siguruar mbijetesën.

IPKO SUPERLIGA

Feronikeli - Trepça '89	5-0
Gjilani - KEK-u	2-0
Llapi - Ballkani	1-1
Drita - Liria	2-0
Drenica - Ferizaj	0-0

Më 27 mars takohen:
14:00 Prishtina - Flamurtari

TABELA

1. Feronikeli	23	55 pikë
2. Llapi	23	48
3. Prishtina	22	47
4. Drita	23	38
5. Gjilani	23	32
6. Drenica	23	30
7. Ballkani	23	29
8. Trepça '89	23	28
9. Flamurtari	22	28
10. Ferizaj	23	25
11. Liria	23	24
12. KEK-u	23	1

Në xhiron e radhës takohen: KEK-u-Drenica, Gjilani-Trepça '89, Liria-Llapi, Flamurtari-Feronikeli, Ballkani-Prishtina, Ferizaj-Drita.

LIGA E PARË

Dukagjini - Arbëria	3-0
Vushtrria - Vitia	1-0
Bashkimi - Trepça	1-0
Istogu - Besa	1-4
Fushë Kosova - Onix	1-0
Ramiz Sadiku - Vëllaznimi	1-0
2 Korriku - Vllaznia (P)	1-0
Drenasi - Kika	1-1

TABELA

1. Vushtrria	20	47 pikë
2. Besa	20	44
3. Dukagjini	20	40
4. Vitia	20	37
5. Vëllaznimi	20	36
6. Onix	20	31
7. Trepça	20	27
8. Arbëria	20	26
9. 2 Korriku	20	24
10. Fushë Kosova	20	23
11. Istogu	20	23
12. Drenasi	20	22
13. Kika	20	19
14. Ramiz Sadiku	20	18
15. Bashkimi (K)	20	16
16. Vllaznia	20	15

SHKURT

Rashica shënon në fitoren ndaj Leverkusenit

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Milot Rashica, ka vazhduar me formë të mirë në Bundesliga. Shqiptari nga Vushtrria ka shënuar edhe një gol për skuadrën e Werder Bremenit në fitoren ndaj Bayer Leverkusenit (1-3). Dy golat e tjerë për Bremenin i shënoi sulmuesi Max Krus, kurse për vendësit golin e vetëm e realizoi Leon Bailey. Rashica numëron 18 ndeshje këtë sezon në Bundesliga, 11 prej të cilave si titullar dhe ka arritur të shënojë 7 gola dhe të japë një asistim.

Ademi takohet me përzgjedhësin Challandes, vizitojnë stadiumin 'Fadil Vokrri'

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka takuar sot përzgjedhësin e Përfaqësues A, Bernard Challandes, të cilit ia shprehu mbështetjen e plotë të tij, të Komitetit Ekzekutiv dhe të stafit të përfaqësueses për fillimin e misionit të ri në kualifikimet për Kampionatin Evropian 2020. "Në këtë takim ishte i pranishëm edhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu, ku u diskutua çdo detaj sa i përket organizimit të dy ndeshjeve që i kemi para vetës, kundër Danimarkës dhe kundër Bullgarisë, e me ç'rast u tha edhe një herë se do të vazhdojmë me krenari dhe përgjegjësi t'i përmbushim gjithsecili detyrat", thuhet në njoftimin e FFK-së. Pas takimit, kryetari Ademi dhe përzgjedhësi Challandes kanë vizituar edhe stadiumin "Fadil Vokrri", ku kanë parë nga afër gjendjen e fushës.

Mavraj: Ika nga Greqia sepse s'kishte xhami për t'u falur

Kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Mërgim Mavraj, në intervistë për "Telesport", ka thënë se arsyeja kryesore e largimit të tij nga Greqia ishte se nuk kishte xhami për t'u falur. "Nga Greqia ika shumë shpejt sepse arsyeja kryesore ishte se nuk kishte xhami për t'u falur. E them me plot sinqeritet, sepse jeta e futbollistit nuk është vetëm loja në fushë. Janë dhe shumë orë të tjera që njeriu i kalon në jetën private dhe mua më mungonte shumë xhamia. Nuk kishte xhami fare aty. Unë isha mësuar me këtë gjë, me vëllezërit e mi, me gjëra që më relaksojnë jashtë futbollit, më pas ato aktivitet e mia që janë të lidhura me fenë time, me shokët e mi. Nuk isha aty për pushim dhe nuk e kisha ndërmend të bëja jetë luksoze apo të shkoj çdo ditë në plazh, por kisha synime. Këto nuk u përputhën në fund fare. Nuk ika me ndonjë keqardhje apo keqkuptim, trajneri nuk pati dëshirë fare, por i thashë ose iki ose e lë futbollin. Kështu që nuk u lashë zgjidhje tjetër", ka deklaruar Mavraj.

Muhamed Sejdini, presidenti i parë shqiptar i Federatës së Futbollit të Maqedonisë

SHKUP, 17 MARS - Shqiptari Mohamed Sejdini është zgjedhur president i Federatës së Futbollit të Maqedonisë, (FFM) të dielën në një kuvend zgjedhor. Në Kuvendin Zgjedhor të FFM-së, Muhamed Sejdini, si kandidat i vetëm i FFM-së, mori pëlqimin e 82 delegatëve nga 90 të pranishmëve. Mandati i tij do të jetë deri në vitin 2021, deri në zhvillimin e Kuvendit të rregullt të FFM-së. Në paraqitjen e parë si president i FFM-së, Sejdini para delegatëve potencoi se federata do të jetë e hapur për idetë e reja për përmirësimin e futbollit vendor. "Dua t'ju falënderoj të gjithëve për besimin e dhënë. Është një nder i madh që të jesh në krye të kësaj organizate dhe dua t'i falënderoj të gjithë për bashkëpunimin e deritanishëm dhe në kohë të njëjtë mezi pres sfidat e reja. Nga të gjithë ne këtu, jo vetëm nga unë, pritet që ta përmirësojmë mënyrën e funksionimit të Federatës së Futbollit dhe futbollit në përgjithësi. FFM është këtu për idetë e reja që do t'i ndihmojnë futbollit në Maqedoni. Unë dua t'i falënderoj FIFA-n dhe UEFA-s për përkrahjen, ndërsa i gëzohem bashkëpunimit të ardhshëm siç ishte deri më tani dhe se do të jemi krenarë të projekteve të përbashkëta në të ardhmen. FFM do t'u japë përkrahje të gjithë kombëtareve", ka thënë Sejdini.

Kryeziu për UEFA-n: Kosova, vend i 'çmendur' pas futbollit

PRISHTINË, 17 MARS - Protagonist i radhës në ciklin e intervistave për UEFA ishte mesfushori i Përfaqësueses së Kosovës dhe anëtari i Cyrihut, Hekuran Kryeziu. Gjatë kësaj interviste Hekurani tregoi se Kosova është një vend që jeton me futbollin dhe njerëzit janë të pasionuar pas sportit më të popullarizuar në botë. "Njerëzit në Kosovë gjithmonë përcjellin futbollin dhe ligat ndërkombëtare, dhe nëse vendi i tyre luan kundër kombëtareve të mëdha si, për shembull, kundër Anglisë në kualifikimet për Euro 2020, atëherë pa dyshim është ndjenjë e madhe për ta të shohin ekipin e tyre në stadium. Deri tani i kemi pasur tri ndeshje në shtëpi dhe për secilën ndeshje biletat shiteshin brenda një ore", ka thënë Kryeziu. Sa iu përket kualifikimeve për "Euro 2020", Kryeziu është shprehur: "Do të jetë një përvojë e re për secilin prej nesh dhe definitivisht do të jetë më e vështirë se Liga e Kombeve. Por, pavarësisht se jemi një vend i vogël dhe i ri, nuk duam të fshihemi. Ne i respektojmë kundërshtarët tanë, por nuk u frikësohemi. Ne do të përpiqemi të rrëmbejmë pikë nga kombëtare të mëdha si Anglia".

Panucci: Turqia superiore, por besoj te fitorja

TIRANË, 17 MARS - Trajneri i kombëtares shqiptare, Christian Panucci, ka dalë para gazetarëve në Tiranë për t'i prezantuar dy ndeshjet e para kualifikuese për "Euro 2020", kundër Turqisë dhe Andorrës, këtë muaj. Panucci është dukur entuziast dhe me shumë besim te kombëtarja, ndoshta edhe për faktin se tashmë ka një grup thuajse të plotë dhe lojtarët po luajnë rregullisht në klubet përkatëse.

Çfarë prisni ndryshe, duke qenë se keni premtuar ndryshime?
Panucci: Sjellja në fushë po, ajo duhet ndryshuar. Edhe taktikisht do të bëjmë pak ndryshime, kemi rikuperuar disa lojtarë dhe diçka do ta ndryshojmë. Mund të luajmë me 4-3-3 ose me 3-5-2, të shohim. Nuk do të luajmë thjesht në mbrojtje, por kam kuptuar që kam gabuar. Sa më shumë hapemi në fushë, aq më shumë probleme kemi.

A jeni i kënaqur me skuadrën, pas kthimit të shumë lojtarëve?
Panucci: Jam i kënaqur me këta 23 lojtarë që kemi, por mund të vijnë të tjerë. Kisha grumbulluar Cikalleshin, por ai u dëmtua. Është edhe Ndoj i dëmtuar. Binaku ka probleme muskulore. Kthehet Abrashi, kthehet Ajeti, Grezda më në fund u kthye në fushë dje, edhe pse ndoshta nuk ka 90 minuta në këmbë. Kaçe po luan rregullisht, është kthyer në kombëtare, ndërsa më parë nuk luante. Ka shumë futbollistë shqiptarë nëpër Evropë që nuk luajnë rregullisht dhe ky grup luan mjaftueshëm. Kemi Qosen që vjen në kombëtare, e kam ndjekur gjatë gjithë dimrit, të tjerët janë të njëjtët. Mavraj është i pezulluar, të shohim si është Sadiku, sepse është shumë i rëndësishëm për ne.

Çfarë duhet të bëjë Bare më shumë për të luajtur në kombëtare?
Panucci: Ç'lidhje ka Bare, është gjë miku yt? Do të shkoj ta shoh, se është edhe Marbella afër. Mund të jenë shumë të tjerë që mund të vijnë në kombëtare.

Planet janë për ndeshjen e radhës, apo për gjithë eliminatoret?
Panucci: Duhet të shohim vetëm ndeshjen e radhës, sepse kam parë që këtu kalohet lehtë në eufori. Jam i bindur se mund të bëjmë diçka speciale, përndryshe iki. Thjesht duhet të jemi të qetë dhe të përulur, sepse më duket se 2016-a nuk u ka bërë mirë disa njerëzve. Jam i bindur që mund të bëjmë shumë mirë ndaj Turqisë, mund të provojmë të fitojmë.

Vrushaj e Durmishaj na braktisën. Po me Tahirajn e Seferin, e keni pasur kontakte?
Panucci: I kemi nën vëzhgim, janë në planet tona për të ardhmen. Vrushaj e Durmishaj kanë bërë zgjedhjen e tyre, kanë ikur te Greqia.

Lenjani, pse mungon këtë radhë?
Panucci: Sepse janë Binaku dhe Aliji.

Duket sikur kemi pak zgjedhje nga krahët...
Panucci: Jo, kemi shumë lojtarë nga krahët, kemi Grezdën, Uzunin, kemi mbrojtësit e krahut që janë të aftë të luajnë edhe më përpara.

Mbrojtja, si do të ndryshojë, duke qenë se kemi pësuar shumë gola kohët e fundit?
Panucci: Problemi ka qenë mënyra e lojës. Do të jemi më kompaktë dhe do ta ndihmojmë mbrojtjen me mënyrën si luajmë. Gjimshiti luan tek Atalanta, Hysaj te Napoli dhe Ismajli te Hajduk Split. Formacioni? Do të luajmë 4-4-2 (qesh.). Do ta ndryshoj gjatë gjithë javës.

Si e shihni Turqinë, sa e njihni?
Panucci: Është një skuadër e fortë, superiore ndaj nesh. Sapo ka ndërruar trajner. Duhet të tregohemi më të fortë për ta mundur, por kam besim te djemtë e mi. Mundohem të jem gjithnjë pozitiv dhe besoj se mund të fitojmë. Mungon Under te Turqia. Ky është një lajm i mirë për ne, por duhet të shohim si do të luajë Turqia, sepse trajneri i ri luan zakonisht 4-2-3-1. Megjithatë, mendoj më shumë për ekipin tim. I kam idetë e qarta çfarë duhet të bëjmë, duhet ta luajmë lojën tonë, por natyrisht do të ketë ndryshime në skemë nga Turqia tek Andorra.

Berisha apo Strakosha, për portën?
Panucci: Kur bëj formacionin, zakonisht dy të parët nuk i gaboj kurrë. Berisha apo Strakosha, dhe pastaj Hysaj. Kam ende dyshime aty, të shohim. Mbrojtjen pak a shumë e morët vesh, e thashë më sipër.

A ka lojtarë për kombëtaren Kategoria Superiore?
Panucci: Shumë e vështirë, kampionati shqiptar i jep shumë pak kombëtares. Kampionati çon lojtarë jashtë dhe më pas më të mirët vijnë në kombëtare. Realiteti është i tillë, edhe pse i ndjekim të gjithë.

Abrashi, sa i rëndësishëm është për ne?
Panucci: Është lojtar me peshë, me shumë përvojë. Na duhet shumë forca e tij, tërbimi, agresiviteti. Duhet ta kemi të qartë kush jemi ne.

Durmishaj, mos ndoshta duhej të luante pak minuta sa për ta djegur, si Vrioni?
Panucci: Këtë radhë grumbullova vetëm dy sulmues. Vrioni është shumë i rëndësishëm dhe ka të ardhme të shkëlqyer, thjesht i duhet të piqet. Durmishaj është lojtar i ngjashëm, të shohim sa do të luajë për Greqinë. Vendimi i tij duhet respektuar, çdokush bën atë që do, por problemi është që në fillim thonë "po", pastaj "jo", pastaj dërgon ndonjë mesazh dhe përgjigjet menaxheri. Këta lojtarë që bëjnë kështu nuk do të bëhen kurrë lojtarë të vërtetë. Një lojtar i vërtetë e thotë me bindje "po", "jo", nuk qurravitet. Këta janë lojtarë me "ko*e", jo ata si Durmishaj që sapo i kërkon Greqia apo një kombëtare tjetër, u prishet mendja. Këtu jam gati të vendos bast: Durmishaj nuk do të bëhet kurrë lojtar i rëndësishëm. Këtu do të jemi, do të flasim pas dy vjetësh. Shkova të takoj një lojtar, erdhën babai, menaxheri, xhaxhai, kryetari i bashkisë, m'u duk sikur ishte Messi. Nuk e di fare ku luan tani. "Nuk e di, duhet të mendohem, të flas me menaxherin, me babin". Për çfarë, menaxheri e vendos jetën tënde? Isha me një drejtues të Federatës, i thashë "nuk vlen, hiqi vizë". Menaxheri e trajtonte sikur të ishte Cristiano Ronaldo.

Roma, a ka pasur diçka reale?
Panucci: Nëse kanë menduar për mua, nuk e di. Megjithatë, nuk kam marrë asnjë telefonatë, zero. Po të kisha marrë një telefonatë, një sekondë më vonë do ta telefonoja presidentin Armand Duka, për ta njoftuar, sepse respekti për mua është shumë i rëndësishëm. Mua më paguan FSHF dhe nuk mund të flas me asnjë ekip tjetër për sa kohë jam i Shqipërisë. Jam i lumtur këtu, nuk e di për ju.

SHKURT

Rahoveci e shkatërroi Borean

Skuadra e Rahovecit ka regjistruar fitore shumë të lartë (159-54) përballë Boresë në ndeshjen e javës në Superligën e Kosovës në basketboll. Që në çerekun e parë të ndeshjes në "Mizahir Isma" vendësit ishin dominues, duke i shënuar 30 pikë dhe duke i pranuar 14 sosh. Ata e morën lojën në dorë në dhjetëminutëshin e dytë (45:14), duke qenë shumë më bindës dhe shkuan në pushim me epërsi shumë të lartë. Loja fantastike e nikoqirëve vazhdoi edhe në fraksionin e tretë (42:8), ndërsa në çerekun e katërt (42:18) i dhanë vulë fitores me 105 pikë epërsi (159-54).

Golden State shpartallon Oklahomën

Kampionët e Golden States kanë triumfuar 110-88 në fushën e Oklahomës, në përballjen e dy prej ekipeve më të mira në Konferencën e Perëndimit. Ndeshje e dominuar nga skuadra kampione, që pati epërsi në fushë gjatë gjithë kohës. Mungesa e Durantit nuk u ndie fare te Warriorsi, sfidë ku dallimin e bëri Curry, autor i 33 pikëve, mbështetur edhe nga Thompsoni me 23 pikë. Një ndeshje e dobët e Westbrookut, që realizoi vetëm 7 pikë, ndërkohë që u dallua Paul George me 29 pikë e 13 rebounde, por që mbetën për statistikë. Fiton edhe skuadra e San Antonios, që mundi 108-103 Portlandin në sekondat e fundit, duke korrur një fitore të rëndësishme për "play off". Ndeshje me luhatje, ku herë udhëhiqte njëra skuadër e herë tjetra, por në fund u shkëput Spurs. DeRozan me 21 pikë ishte shënuesi më i mirë, ndërkohë që 7 lojtarë të San Antonios realizuan mbi 10 pikë. Rezultatet: Boston - Atlanta (129-120), New Orleans - Phoenix (136-138), Washington - Memphis (135-128), Dallas - Cleveland (121-116), Oklahoma - Golden State (88-110), San Antonio - Portland (108-103), Denver - Indiana (102-100), Utah Jazz - Brooklyn (114-98).

Celina: Humbja ndaj Cityt, vështirë të pranohet

Swansea City nuk arriti gjysmëfinalen e FA Cupës pasi pësoi humbje nga Manchester City me rezultat 2-3 në çerekfinale. Më i miri në këtë ndeshje për skuadrën vendëse ishte ylli i Përfaqësueses së Kosovës, Bersant Celina, i cili, përveç golit, arriti të bëjë një paraqitje fantastike. "Isha i lumtur që shënova pas penalltisë së humbur në mesjavë. Djemtë ishin fantastikë si ekip dhe arritëm të ndërtonim një fillim të mirë të ndeshjes dhe të merrnim gola. Plani i ndeshjes funksionoi. I vendosëm në presion dhe tentuam t'ia bëjmë sa më të vështirë lojën. Nuk është befasi të humbasësh ndaj një skuadre fantastike, por kur je në epërsi 2-0 atëherë fillon të besosh se mund të fitosh", ka thënë Celina. "Ia arritëm të bëjmë aq mirë ndaj një prej skuadrave më të mira në botë, por humbja është vështirë për t'u pranuar. Shpresoj që ta përdorim këtë paraqitje për të na motivuar në ligë. Nëse luajmë si ndaj Manchester Cityt, mendoj se mund t'ia arrijmë ndaj çdo skuadre në kampionat", ka shtuar Celina.

Pato largohet nga Kina

Sulmuesi brazilian Alexandre Pato është larguar nga skuadra e Superligës së Kinës, Tianjin Tianhai. "Aventura ime në Kinë ka përfunduar. Këta dy vjet në Kinë për mua ishin të lumtura dhe përvojë e re në karrierën time. Jam krenar që kam qenë pjesë e këtij ekipi, të cilin e falënderoj për të gjitha", ka shkruar Pato në rrjetet sociale. 29-vjeçari për ekipin kinez ka zhvilluar në total 47 ndeshje dhe ka shënuar 30 gola në të gjitha garat.

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

SHPALL
KONKURS

Në bazë të nenit 12, paragrafi 4 i Ligjit për Shërbimin civil nr.03/L-149, bazuar në nevojën për funksionim dhe realizim të detyrave dhe obligimeve, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), shpall konkurs "Marrëveshje për shërbime të veçanta" për kandidatët e interesuar dhe të kualifikuar për vendin e punës:

Titulli: **Asistent/e administrativ**

Departamenti:	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Koeficienti:	6
Kontrata:	Jo i karrierës
Orari:	i plotë (40 orë në javë)
I raporton:	Drejtorit

Detyrat e punës:

- Përkujdesja për punët në zyrë
- Mirëmbajtja dhe përditësimi i agjendës së punës në zyrën e drejtorit;
- Puna me palë
- Mirëmbajtja dhe arkivimi i shkresave zyrtare
- Verifikimi, vulosja dhe protokollimi i Certifikatave nga institucionet e akredituara
- Komunikimi me institucione dhe grupe të interesit
- Mirëmban librin e Protokollit dhe procedon shkrsa në/nga institucione të ndryshme
- Mban shënime zyrtare sipas kërkesës në takime zyrtare
- Kryen edhe detyra sipas nevojës së AKK

Shkathtësitë e kërkuara: (*Kualifikimet, përvojat dhe aftësitë tjera)*

- Diplomë bachelor, 2 vite përvojë;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e arsimit;
- Njohuri për institucionin dhe aktet ligjore mbi të cilat funksionon Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve;
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punëve;
- Bashkëpunim me stafin dhe palët e interesit;
- Shkathtësi vlerësimi dhe këshillimi për punët administrative;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Njohje të punës me kompjuter (Word, Excel, PowerPoint, Access, Internet).

Shërbimi Civil i Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës.
Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Dokumentet e pakompletuara apo të dërguara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Aplikacioni për konkurrim(formulari) mund ta merret dhe dorëzohet në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, Adresa: Rr. "Agim Ramadani" nr. 26, Qendra e Studentëve (zyra e administratës).

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 7 ditë nga dita e shpalljes së konkursit (26.03.2019).

Me rastin e aplikimit kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:

- ***Diplomën e shkollimit (e vërtetuar te noteri)***
- ***Nëse diploma është e fituar jashtë vendit të jetë e nostrifikuar***
- ***Vërtetim mbi përvojën e punës dhe pasqyra nga trusti pensional***
- ***Certifikatë që nuk jeni nën hetime***
- ***Dokumentin e identifikimit***

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

OBJAVLJUJE
KONKURS

Na osnovu člana 12, stav 4 Zakona o civilnoj službi br. 03 / L-149, na osnovu potrebe za funkcionisanje i izvršavanje dužnosti i obaveza, Nacionalno autoritet za kvalifikacije (NAK) objavljuje Konkurs " Ugovor o posebnim uslugama" za zainteresovane i kvalifikovane kandidate za radno mesto:

Zvanje: **Administrativni asistent/ca**

Departament:	Nacionalni autoritet za kvalifikacije
Koeficijent:	6
Ugovor:	Ne u karijeri
Radno vreme:	puno (40 sati nedeljno)
Izveštava:	Direktora

Radni zadaci:

- Stara se kancelarijske poslove
- Održavanje i ažuriranje radne agende u kancelariji direktora;
- Radite sa strankama
- Održavanje i arhiviranje službenih dokumenata
- Verifikacija, pečatiranje i protokolisanje Certifikata od strane akreditovanih institucija
- Komuniciranje sa institucijama i interesnim grupama
- Održava knjigu protokola i procesuira dopise u / iz različitih institucija
- Vodi službene zapisnike prema zahtevima na službenim sastancima
- Obavlja zadatke u skladu sa potrebama NAK-a

Potrebne veštine: (*Kvalifikacije, iskustva i druge veštine)*

- Diploma bachelor, 2 godine iskustva;
- Znanje i iskustvo u oblasti obrazovanja;
- Poznavanje institucije i pravnih akata prema kojima deluje Nacionalni autoritet za kvalifikacije;
- Veštine u komunikacije i planiranju poslova;
- Saradnja sa osobljem i zainteresovanim stranama;
- Veština procenjivanja i savetovanje za administrativne poslove;
- Sposobnost za obavljanje poslova i rada pod pritiskom;
- Poznavanje rad na kompjuteru (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijavljivanje žena i muškaraca svih zajednica na Kosovu.
Nevećinske zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravednu i proporcionalnu zastupljenost u organima državne službe u centralnoj i lokalnoj javnoj upravi, kao što je navedeno u članu 11. stav 3. Zakona br. 03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosova..

Nepotpuna dokumenta ili dokumenta poslata nakon isteka roka neće biti razmatrani.

Aplikacija za konkurisanje (obrazac) se može dobiti i dostaviti Nacionalnom autoritetu za kvalifikacije, Adresa: Ul. "Agim Ramadani" br. 26, Studentski centar (administrativni ured).

Rok za podnošenje prijava je 7 dana od dana objavljivanja konkursa (26.03.2019).

Prilikom prijave kandidati moraju dostaviti sljedeća dokumenta:

- ***Diploma o školovanju (overen kod notera)***
- ***Ako je diploma stečena u inostranstvu, treba biti nostrifikovana***
- ***Potvrda o radnom iskustvu i finansijskim izveštajima iz Trusta***
- ***Potvrda da niste pod istragom***
- ***Identifikacioni dokument***

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. nr. 03/L-149, dhe Rregulloren nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Zyrtar për Buxhet dhe Financa ne QRTK Prishtinë
Kategoria funksionale-Koeficienti : 7
Numri i referencës: 17 /2019
I përgjigjet: Drejtorit te QRTK Prishtinë
Vendi: Prishtinë
Lloji i kontratës:"Marrëveshje për Shërbime të Veçanta" (kohëzgjatje 6 muaj).
Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit te QRTK Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve dhe produkteve përkatëse;
2. Kryen detyra të specializuara, sipas kërkesës, në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
3. Kryen detyrat në fushën profesionale specifike me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme;
4. Bën hulumtime dhe analiza sipas kërkesës dhe kontribuon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim nga nivelet më të larta;
5. Merr pjesë në grupe punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë.
6. Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët;
7. Raporton rregullisht te mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
2. Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
3. Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ;
4. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
5. Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Diplomë universitare, Fakulteti Ekonomik, minimum dy 2(vjet) përvojë pune profesionale.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të caktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur 8 (tetë) ditë.

Data e fundit e aplikimit është: 25.03.2019

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni mund te shkarkohet nga Web faqja e MKRS-se dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211 449 dhe 038 211 921 (apo në ueb-faqen http://www.mkrs-ks.org/.

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Na osnovu Zakona o Radu br. 03/L-212, Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova, Br. 03/L-149, i Uredbe Br. 02/2010, o Procedurama Zapošljavanja u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta objavljuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Zvaničnik za Buzdet i Finansije u RCKB Priština
Funkcionalna Kategorija: Koeficienat 7
Broj referencije: 17/2019
Odgovoran je: Direktoru RCKB Priština
Mesto: Priština
Vrsta ugoovora: "Sporazum o posebnim uslugama" (vremensko trajanje 6 meseci)
Zadaci i odgovornosti: Pod nadzorom Direktora RCKB Priština , izvršava dole navedene zadatke i odgovornosti:

Zadatke i odgovornosti

1.Razvija I postiže saglasnost za planove rada i rokove sa menadžerom I ostalim profesionalnim stafom za sprovođenje dotičnih usluga i proizvoda;
2. Izvršava specializovane zadatke, prema zahtevu, iz specifične profesionalne oblasti u podudarnosti sa dotičnim zakonom, pravilnicima, politikama i prosecurama, unutar određenih vremenskih rokova;
3. Izvršava zadatke iz specifične profesionalne oblasti sa jednim razložnim stepenom nezavisnosti, sa povremenim nadzorom i uputstvima;
4. Vrši istraživanja i analize prema zahtevu i doprinosi u uređenju uputstava za razmatranje od najviših nivoa;
5. Učestvuje u radnim grupama iz specifične profesionalne oblasti. Kada se tako nešto zahteva.
6. Komunicira unutar institucije i van nje za razmenu informacija i razvoj delatnosti iz oblasti zajedničkog interesa;
7. Redovno izveštava kod nadzornika oko progresa, u vezi prihvaćenih planova rada;
8. Izvršava i svaki drugi zadatak iz specifične, profesionalne oblasti, koji se razložno mogu zahtevati s vremena na vreme.

Zahtevao obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

1. Duboko poznavanje specifične, profesionalne oblasti, dobijeno preko univerzitetskog obrazovanja i dotičnih treniranja;
2. Poznavanje zakona i pravilnika koji se sprovode;
3. Sposobnost u komuniciranju za planiranje rada, eventualna koordinacija sa radnim osobljem;
4. Sposobnost za istraživanje, analitiku, procenjivanje i formulisanje profesionalnih preporuka i saveta;
5. Sposobnost na kompjuteru, u aplikovanju programa (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Univerzitetska diploma, ekonomski pravac, minimum jedna (1) godina profesionalnog radnog iskustva.

Procedure konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve kandidate.

Vremensko trajanje imenovanja: Imenovanje je na određeno vreme.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren 8 (osam) dana .

Zadnji datum za aplikovanje je: 25.03.2019

Aplikacije koje se šalju preko pošte, sa poštanskom markicom, na zadnji dan objave, smatraće se validnim.

Podnošenje Zahteva: Aplikacije se preuzimaju sa Ueb stranice MKOS-a, i predaju u kancelariji br. 27 Ministarstva Kulture, Omladine i Sporta, Trg "Majka Tereza" br. 44. Za dodatne informacije kontaktirajte na broj: 038211449 ili 038211921 (ili na web-stranici http://www.mkrs-ks.org/).

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY

FTESA PËR PROPOZIME PËR ORGANIZATAT JO QEVERITARE

Agjencia për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit, shpallë ftesën për propozime me qëllim të përkrahjes financiare të Organizatave Jo Qeveritare, në mënyrë që projekti të jetë i pranueshëm duhet të trajtojë nje apo më shumë nga fushat e mëposhtme:

- Të ndikojë në ndërgjegjësim kundër dhunës në familje, dhunës ndaj grave;
- Të ndikoj ne fuqizimin ekonomik te grave viktima të dhunës në familje;
- Të ndikojë në ndërgjegjësimin rreth çështjes së viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë;
- Të ndikojë në fuqizimin ekonomik të grave (p; sh. Bujqësi, Blegtori, Agrikulturë, Artizanale etj);
- Të promovojë zhvillimin e turizmit rural nën drejtimin e grave/vajzave;
- Të mbështes zhvillimin e gjithanshëm dhe përmirësimin e pozitës së grave në vendimmarrje ekonomi, kulture dhe sport dhe/ apo fusha të tjera.

Ftesa për propozime shpallet në ueb faqen e Agjencionit për Barzazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit https://abgj.rks-gov.net/' dhe në mediat të shtypura, dhe të drejtën e aplikimit e kanë të gjitha OJQ-të e regjistruara në organin kompetent në Republikën e Kosovës.

1. **Kriteret e përgjithshme për aplikuesit:**

- Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesi duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:
- të jenë të regjistruar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;
- të jenë të pajisur me numër fiskal, sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;
- të kenë të kryera të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
- të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete dhe
- të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

2. **Kriteret e vlerësimit nga aspekti përmbajtjesor:**

Me rastin e vlerësimit të projekt-propozimeve do të vlerësohen me sa vijon:

- A posedon aplikuesi përvojë të mjaftueshme dhe kapacitete profesionale për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit /programit
- A janë objektivat e projektit/programit të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme?
- A janë aktivitetet e projektit/programit të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme?
- A janë përcaktuar qartë rezultatet dhe nëse aktivitetet çojnë në arritjen e rezultateve?
- A janë kostot e projektit/programit reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit?
- A janë kostot e projektit në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projektit/programit?

3. Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme, aplikacioni do të konsiderohet i pakompletuar dhe si i tillë nuk mund të kualifikohet për mbështetje financiare.

4. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në faqen e internetit: www.abgj-rks-gov.net.

5. Dokumentacioni i shtypur, duhet të vendosen në një zarf të mbyllur me mbishkrimin.

6. Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: fatime.bajraktari@rks-gov.net .

7. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të ftesës publike janë të detajuara në Udhëzuesin për Aplikim. Dokumentet e kompletuara mund të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:
.
FORMULARËT E FTESËS PËR APLIKIM
1. Formulari i Aplikacionit për Projekt/programit (e detyrueshme)-(Formulari 9
2. Formulari i Buxhetit (e detyrueshme)-(Formulari 10)
3. Formulari i deklaratës për të financimit të dyfishtë (e detyrueshme)-(Formulari 11)
4. Formular i deklaratës se partneritetit (nëse aplikohet)-(Formulari 12)
5. Formulari i deklaratës se projekteve të financuara (e detyrueshme)-(Formulari 13)
6. Deklaratë pranimi për kryerjen e aktiviteteve në projekt (e detyrueshme)-(Formulari 14)

OJQ-të duhet t'i dorëzojnë formularët e plotësuar për aplikim në formë fizike në Agjencionin për Barazi Gjniore në Zyrën e Kryeministrit (Ndërtesa e Qeverisë, Kati VII, Zyra Nr.711).

Afati për aplikim është pesëmbëdhjetë (15) ditë pas datës së publikimit të ftesës për propozime. (18/03/2019 deri 01/04/2019).

Aplikacionet e dorëzuara pas mbylljes së afatit nuk do të merren parasysh.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY

POZIV ZA PODNOŠENJE PREDLOGA ZA NEVLADINE ORGANIZACIJE

Agencija za rodnu ravnopravnost u Kancelariji premijera objavljuje poziv za podnošenje predloga u cilju finansijske podrške Nevladinim organizacijama. Da bi projekat bio prihvatljiv mora da se bavi jednom od sledećih oblasti:

- Da utiče na osvešćivanje protiv nasilja u porodici, nasilja nad ženama;
- Da utiče na ekonomsko osnaživanje žena žrtava porodičnog nasilja;
- Da utiče na osvešćivanje oko pitanja žrtava seksualnog nasilja tokom rata na Kosovu;
- Da utiče na ekonomsko osnaživanje žena (npr. u poljoprivredi, stočarstvu, agrikulturi, rukotvorinama itd.);
- Da promoviše razvoj ruralnog turizma pod upravom žena/devojaka;
- Da podržava svestrani razvoj i poboljšanje položaja žena u donošenju odluka u ekonomiji, kulturi i sportu i/ili u drugim oblastima.

Poziv za podnošenje predloga biće objavljen na veb stranici Agencije za rodnu ravnopravnost u Kancelariji premijera https://abgj.rks-gov.net/' i u štampanim medijima, a pravo na apliciranje imaju sve NVO koje su registrovane pri nadležnom organu u Republici Kosovo.

1. **Opšti kriterijumi za podnosioce aplikacija:**

- Da bi se kvalifikovao za javnu finansijsku podršku, podnosilac aplikacije mora da ispuni opšte minimalne kriterijume utvrđene sledećim odredbama:
- da su registrovani prema zahtevima važećeg zakonodavstva u Republici Kosovo;
- da poseduju fiskalni broj, prema zahtevima poreskog zakonodavstva Republike Kosovo;
- da su izmirili sve obaveze od prethodne finansijske podrške, ako su ostvarili korist od javnih izvora finansiranja;
- da nisu primili sredstva od drugih izvora finansiranja za iste aktivnosti, i
- da ne postoji sukob interesa između podnosioca aplikacije, odnosno predstavnika/rukovodioca podnosioca aplikacije i budžetske organizacije ili javne institucije, kao što je predviđeno važećim zakonodavstvom u Republici Kosovo.

2. **Kriterijumi procene sa sadržajnog aspekta:**

Prilikom procene predloga projekata, biće procenjeni sledeći kriterijumi:

- Da li podnosilac aplikacije poseduje zadovoljavajuće iskustvo i profesionalne kapacitete za sprovođenje planiranih aktivnosti projekta/programa
- Da li su ciljevi projekta/programa jasno definisani i realno ostvarljivi?
- Da li su aktivnosti projekta/programa jasni, opravdani, razumljivi i primenjivi?
- Da li su jasno definisani rezultati i da li aktivnosti vode do ostvarivanja rezultata?
- Da li su troškovi projekta/programa realni u pogledu specifičnih rezultata i očekivanog trajanja projekta?
- Da li su troškovi projekta u skladu sa planiranim aktivnostima projekta/programa?

3. U slučaju neuspeha u ispunjavanju nekog od opštih kriterijuma, aplikacija će se smatrati nepotpunom i, kao takva, ne može se kvalifikovati za finansijsku podršku.

4. Predlozi se moraju podneti samo u predviđenim obrascima, koji su na raspolaganju na internet stranici: www.abgj-rks-gov.net.

5. Štampanu dokumentaciju treba staviti u zatvorenu kovertu sa natpisom.

6. Sva pitanja koja se odnose na javni poziv moguće je razjasniti elektronskim putem, slanjem e-maila na adresi: fatime.bajraktari@rks-gov.net .

7. Proces prijema, otvaranja i razmatranja aplikacija, procene aplikacija, ugovaranje, dodela sredstava, vreme i način podnošenja žalbi, tretiranje dokumenata i pokazni kalendar za sprovođenje javnog poziva, detaljno su predstavljeni u Vodiču za apliciranje. Kompletiranu dokumentaciju možete poslati poštom ili lično, na sledećoj adresi:
.
OBRASCI POZIVA ZA APLICIRANJE
1. Obrazac aplikacije za projekat/program (obavezujuće)-(Obrazac 9)
2. Obrazac budžeta (obavezujuće)-(Formulari 10)
3. Obrazac deklaracije o dvostrukom finansiranju (obavezujuće)-(Obrazac 11)
4. Obrazac deklaracije o partnerstvu (ako je primenjivo)-(Obrazac 12)
5. Obrazac deklaracije o finansiranim projektima (obavezujuće)-(Obrazac 13)
6. Deklaracija o prijemu za sprovođenje aktivnosti u projektu (obavezujuće)-(Obrazac 14)

NVO-i treba da dostave popunjene obrasce za apliciranje u fizičkoj formi u Agenciji za rodnu ravnopravnost u Kancelariji premijera (zgrada Vlade, VII sprat, kancelarija br. 711).

Rok za apliciranje je petnaest (15) dana od datuma objavljivanja poziva za podnošenje predloga. (18.03.2019. do 01.04.2019. godine).

Aplikacije koje su podnete nakon isteka roka neće biti razmatrane.

Njoftimi për shprehje të interesit

Shkolla/komuna: ''Hamëz Thaçi'' – Rahovec
Data: 18.03.2019
Emri i kontratës: Furnizim me kompjutera, kamera me pajisje, projektor dhe mikrofon
Numri i kontratës: ESIP/C1.3/095 - ESIP/SDG/095-G/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe shkollën ''Hamëz Thaçi'' (në Xërxë) – Rahovec. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

1. Kamera – 8 copë
2. Projektor-1 copë
3. Zërues (zmadhues)- 2 copë

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën ''Hamëz Thaçi'', në Xërxë, më së largu deri më 26.03.2019.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës: Setki Kryeziu
Telefoni 044366254
E-mail: setkikryeziu@hotmail.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv.
Tel. 044-413-197, wiber: 045-198-095.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.]

BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
Prishtinë

Gjej PUNË
• Lajme nga tregu i punes
• Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:
- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË PULE
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues

ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L